TRANSPARENCA, LLOGARIDHËNIA DHE EFEKTIVITETI I PUNËS SË KËSHILLIT GJYQ SOR TË RM

Instituti për të Drejtat e Njeriut

Editor
Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shkup

Autorë
Margarita Caca Nikolovska
Vera Koco
Igor Spirovski
Agim Miftari

Redaktorë
Jelena Kadriq
Kristina Doda

Lektura
Tatjana Stojanovska

Përktheu
Blerina Starova Zlatku

Dizajni
Arcuss Design

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

347.97:005.332.5(497.7)(049.5)

ТРАНСПАРЕНТНОСТ, отчетност и ефективност на работата на Судскиот совет на РМ / Маргарита Цаца Николовска ... [и др.]. - Скопје : Институт за човекови права, 2018. - 59 стр. : илустр. ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Автори: Маргарита Цаца Николовска, Вера Коцо, Игор Спировски, Агим Мифтари

ISBN 978-608-66024-4-4
1. Николовска, Маргарита Цаца [автор] 2. Коцо, Вера [автор] 3. Спировски, Игор [автор] 4. Мифтари, Агим [автор]
а) Судски совет - Транспарентност - Македонија - Истражувања
COBISS.MK-ID 106691338

Funded by UK Government

Ky publikim është hartuar në kuadër të Projektit: "Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë", i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Opinionet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë çdoherë opinionet dhe qëndrimet e Qeverisë britanike.

Përmbajtja

Hyrje 4

Rezyme e punës së Këshillit Gjyqësor të RM – Transparenca, llogaridhënia dhe efektiviteti i punës së Këshillit Gjyqësor të RM? 6

Transparenca e punës së KGJRM 11

Llogaridhënia e punës së KGJRM 16

Efektiviteti i punës së KGJRM 17

Zgjedhja e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave 17

Zbatimi i kritereve gjatë procedurës për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave 19

Transferimi dhe delegimi i gjyqtarëve 22

Shkarkimi i gjyqtarëve 24

Shkarkimi i kryetarëve të gjykatave 25

Këshilli për Përcaktimin e Fakteve 26

Analiza e pyetësorëve të dërguar deri te publiku profesionist (deri te avokatët) 27

Pyetësorë për publikun e gjerë 30

Vështrim i shkurtër mbi punën e Këshillit Gjyqësor të R. së Sllovenisë dhe R. së Kroacisë 31

Këshilli Gjyqësor i R. së Sllovenisë 31

Këshilli Gjyqësor i R. së Kroacisë 32

Konkluzione/Rekomandime 34

Hyrje

Këshilli Gjyqësor i RM-së është organ i pavarur i gjyqësorit të cilit i është besuar detyra që ta siguroj dhe garantoj autonominë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Pyetja kryesore të cilës kjo analizë përpiqet t'i përgjigjet është sa në të vërtetë Këshilli Gjyqësor i RM pati sukses ta sigurojë dhe garantojë pavarësinë e gjyqësorit? Performansat, të cilat vlerësohen sipas Metodologjisë[1] së përcaktuar, kanë të bëjnë me transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e Këshillit Gjyqësor të RM (në tekstin në vijim KGJRM) dhe të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit (në tekstin në vijim Këshilli i Fakteve, i cili u suspendua me ligj[2].

Në mënyrë që të zgjidhen problemet me punën e Këshillit Gjyqësor të RM, si dhe të rritet pavarësia e gjyqësorit dhe besimi i qytetarëve ndaj pushtetit gjyqësor, Këshilli Gjyqësor i RM, para së gjithash, duhet të jetë:

- Transparent, përgjegjës dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve;
- I orientuar strategjikisht dhe i fokusuar mbi sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe mbi fuqizimin e performansave dhe efikasitetit të gjyqësorit;
- Shfrytëzues efektiv dhe efikas të parave të obliguesve tatimor.

Këshilli Gjyqësor duhet ta analizoj me kujdes përzgjedhjen e strategjive dhe veprimeve në mënyrë që të siguroj një gjyqësor i cili do të jetë i pavarur, i paanshëm dhe do të punoj në dobi të shoqërisë dhe qytetarëve në tërësi. Kjo analizë e elaboron statusin dhe rolin e Këshillit Gjyqësor, si dhe i analizon ndryshimet të cilat janë shfaqur nga publikimi i analizës themelore në tetor të vitit 2016[3], përmes matjes së indikatorëve të vendosur dhe sublimimit të raporteve të monitorimit gjatë kësaj periudhe.[4] Informacionet, në bazë të të cilave është konstatuar gjendja, janë siguruar përmes monitorimit të vazhdueshëm të mbledhjeve të KGJRM nga ana e Institutit për të Drejtat e Njeriut, përmes informacioneve të aksesshme në ueb-faqen e Këshillit Gjyqësor dhe të dhënave të siguruara përmes qasjes së lirë deri te informacionet me karakter publik.

Nga ana tjetër, edhe Puna e Këshillit të Fakteve shkurtimisht është prezantuar në këtë tekst, meqë ky organ, nga viti 2015[5], ishte kompetent për pranimin e parashtresave nga personat fizikë dhe juridikë dhe për ngritjen e procedurës për përgjegjësinë e gjyqtarit duke vepruar sipas parashtresave ose sipas zërit të dëgjuar. Propozim-ligji për anulimin e Këshillit të Fakteve u miratua nga ana e Kuvendit të RM dhe u publikua në Gazetën Zyrtare të RM, në janar të vitit 2018, me ç'rast ky trup pushoi së ekzistuari. Parashtresat për përgjegjësinë e gjyqtarit ose për kryetarin e gjykatës, sërish do të vazhdojnë të paraqiten në Këshillin Gjyqësor të RM-së.

Sa u përket gjendjeve të konstatuara dhe rekomandimeve të ofruara për tejkalimin e problemeve, si bazë janë shfrytëzuar kompetencat të cilat i posedon Këshilli Gjyqësor, konform legjislacionit vendas, si dhe konform dokumenteve dhe rekomandimeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me punën e trupave të këtillë, konform praktikës dhe legjislacionit të shteteve të tjera në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit në tërësi.

Në fund është prezantuar një vështrim i shkurtër i përgjigjeve të pranuara nga publiku i gjerë, sa i përket njohurive të tyre në lidhje me punën e KGJRM, si dhe i përgjigjeve të pranuara nga avokatët sa i përket mendimit dhe përvojës së tyre në lidhje me punën e KGJRM dhe Këshillit për Përcaktimin e Fakteve. Këto përgjigje shërbejnë

1 Metodologjia për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor të RM dhe të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve, I aksesshëm në: http://ihr.org.mk/p.php?pid=182.

2 Gazeta Zyrtare e RM, nr. 11 nga data 18.01.2018, miratuar në përputhje me planin qeveritar 3-6-9 për reformën në jurisprudencë.

3 Analiza bazike e punës së Këshillit Gjyqësor të RM, E aksesshëm në: http://ihr.org.mk/uploads/publications_pdf/Analiza%20(MAK)%20web.pdf.

4 Raporte numër: 1, 2, 3 dhe 4, për periudhën kohore nga muaji nëntor 2016, deri në nëntor të vitit 2017. Të aksesshëm në: http://www.ihr.org.mk/project.php?pid=104.

5 Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit

që të përcaktohet ndryshimi i mundshëm i gjendjes lidhur me njohuritë dhe perceptimin për këto organe nga publiku i përgjithshëm dhe profesional, krahasuar me anketën e realizuar të fundit në tetor të vitit 2016[6].

Gjatë zbatimit të projektit në debatet publike, të cilat organizoheshin pas publikimit të çdo raporti të monitorimit, si folës kishim juristë të shquar, gazetarë, përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe kryetarin e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve.

Në njërin nga debatet, si ekspertë kishim gjyqtarë të shquar, ish-kryetarë dhe anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Sllovenisë të cilët i shkëmbyen përvojat për punën e këtyre organeve në vendet e tyre. Për këtë shkak, për ta siguruar vizibilitetin e praktikave të mira dhe zbatimin e tyre të mundshëm, në fund të kësaj analize është prezantuar legjislacioni dhe zbatimi praktik i punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kroacisë dhe Këshillit Gjyqësor të Republikës së Sllovenisë sa i përket transparencës dhe efektivitetit.

6 Analiza bazike e punës së Këshillit Gjyqësor të RM, Instituti për të Drejtat e Njeriut, f. 32. E aksesshme në: http://ihr.org.mk/uploads/publications_pdf/Analiza%20(MAK)%20web.pdf.

Rezyme e punës së Këshillit Gjyqësor të RM – Transparenca, llogaridhënia dhe efektiviteti i punës së Këshillit Gjyqësor të RM?

Transparenca

ASipas "Rezolutës për transparencë dhe qasjes në drejtësi" , miratuar në Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë,[8] qasja publike në diskutimet e Këshillit Gjyqësor dhe publikimi i vendimeve të tij duhet të garantohen me ligj dhe të zbatohen në praktikë[9].

Këshilli Gjyqësor, me qëllim që ta ruaj sundimin e së drejtës, duhet të bëjë çdo gjë në mënyrë që ta siguroj implementimin e sistemit të hapur dhe transparent të drejtësisë.

Këshilli Gjyqësor duhet t'i përmbush obligimet e tij:

- Të siguroj transparencë në mënyrën me të cilën i plotëson të gjitha funksionet e veta;
- Të siguroj informacione të mjaftueshme për publikun dhe për mediat, në mënyrë që të sigurojnë perceptim të saktë për zbatimin e drejtësisë nga ana e publikut;
- Raportime të rregullta në lidhje me atë se si ky trup i kryen funksionet e tij[10].

Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM si dhe Rregullorja e punës së Këshillit Gjyqësor[12] e garantojnë transparencën e mbledhjeve: "Mbledhjet e Këshillit janë publike". Megjithatë, në vazhdim theksohet se "Publiku mund të përjashtohet vetëm me vendim të Këshillit për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe integritetit të gjyqtarit ose të kandidatit për gjyqtar. Për punën e mbledhjes së Këshillit mbahet procesverbal dhe shënime stenografike."[13]

Sipas OSBE, rekomandimet nga Kievi, në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit,[14] transparenca duhet të jetë rregull edhe sa u përket procedurave disiplinore të gjyqtarëve. Procedurat duhet të jenë transparente, përveç nëse gjyqtari, kundër të cilit zhvillohet procedura, kërkon të jetë e mbyllur. Në këtë rast Këshilli Gjyqësor do të vendos nëse kërkesa është e arsyeshme. Vendimet që kanë të bëjnë me masën disiplinore duhet të arsyetohen dhe t'i përmbajnë shkaqet për vendimet përfundimtare. Vendimet duhet të publikohen. Gjatë procedurave disiplinore, gjyqtarit duhet t'i sigurohen masa mbrojtëse procedurale, duke e përfshirë edhe të drejtën e prononcimit për mbrojtje, si dhe të drejtën e ankesës deri te gjykata kompetente.[15]

<u>TRANSPARENCA – Rezyme nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor në periudhën kohore nëntor 2016-shkurt 2018:</u>

- Mbledhjet e Këshillit Gjyqësor, në periudhën e monitorimit, ishin të hapura për publikun, përveç në rastet kur vendosej sipas Kërkesave për përcaktimin e kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të

7 Resolution on Transparency and Access to Justice, Adopted in Bucharest (RO), European Network of the Councils for the Judiciary. I aksesshëm në: https://www.encj.eu/images/stories/pdf/opinions/resolutionbucharest29may_final.pdf.

8 Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë - European Network of Judicial councils (ENJC) i bashkon institucionet nacionale në vendet-anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat janë të pavarura nga pushteti ekzekutiv dhe ligjvënës dhe të cilët janë përgjegjës për mbështetjen e gjyqtarëve në zbatimin e pavarur të drejtësisë. Qëllimi është përmirësimi i bashkëpunimit dhe mirëkuptimit të mirë të ndërsjellë midis Këshillave gjyqësorë dhe anëtarëve të gjyqësorit të vendeve-anëtare dhe kandidatëve për vende-anëtare të Bashkimit Evropian.

9 Ibid.

10 Ibid.

11 Neni 33, Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM.

12 Neni 10, Rregullorja e punës së Këshillit Gjyqësor të RM.

13 Ibid.

14 Kyiv recommendations on Judicial independence in Eastern Europe, South Caucasus and Central Asia, Judicial Administration, Selection and Accountability - OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights and Max Planck Minerva Research Group on Judicial Independence Kyiv, 2010, f. 6. I aksesshëm në: http://www.osce.org/odihr/kyivrec?download=true.

15 Ibid.

funksionit të gjyqtarit, si dhe gjatë notimit të rregullt ose të jashtëzakonshëm të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave;

- Në një rast, edhe pse nga kryetari i një gjykate u kërkua që notimi i jashtëzakonshëm të jetë publik, Këshilli Gjyqësor nuk lejoi që mbledhja të jetë transparente, me arsyetimin se procedura e notimit të gjyqtarëve nuk është publike për shkak të mbrojtjes së reputacionit të gjyqtarit dhe për këto shkaqe KGJRM nuk lejon që kjo procedurë të jetë transparente edhe pse gjyqtari ka kërkuar të jetë transparente.[16]
- Komunikatat për mbledhjet e caktuara publikohen rregullisht në internet faqen www.sud.mk në pjesën "Këshilli Gjyqësor";
- Vendimet për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave publikohen në ueb-faqe;
- Ueb-faqja i përmban të gjitha fushat dhe është e qartë, por nuk është e lehtë për kërkime, ndërsa informacionet nga ueb-faqja paraprake nuk janë bartur plotësisht;

Komunikatat për publikun kryesisht kanë të bëjnë me njoftimin për mbledhjen e mbajtur dhe me njoftimin nga mbledhja e mbajtur, takimet zyrtare, si dhe pjesëmarrja në konferenca dhe forume ndërkombëtare të anëtarëve të KGJRM dhe ngjashëm. Në raportet e tij vjetore për punën e Këshillit Gjyqësor thekson se "veçanërisht mban llogari për transparencën gjatë realizimit të aktiviteteve në kompetencë të Këshillit, si dhe ndërtim të marrëdhënies profesionale gjatë realizimit të komunikimit me publikun..."[17]

Duke e pasur parasysh se konfidencialiteti i mbledhjeve, konform ligjit, është parashikuar vetëm për shkak të mbrojtjes së integritetit dhe reputacionit të gjyqtarit i cili notohet, përjashtimi i publikut, në rastet kur vet gjyqtari kërkon procedurë transparente, duhet të rishikohet, meqë përmes sigurimit të transparencës Këshilli Gjyqësor do të ishte i mbrojtur nga spekulimet, ndërsa publiku do të ishte dëshmitarë i punës profesionale të KGJRM.[18]

Sigurimi i transparencës, përveç transparencës së mbledhjeve dhe azhurnimit të rregullt të faqes së internetit, e përfshin informimin proaktiv të publikut për çështje të cilat janë me rëndësi kruciale për sigurimin e pavarësisë. Nga ana tjetër, si konkluzion, mund të konstatojmë se megjithatë, mungon aspekti thelbësor i transparencës që t'i perceptoj bazat dhe shkaqet e vendimeve që i miraton Këshilli Gjyqësor.

Këshilli Gjyqësor nuk duhet të fokusohet vetëm në masat formale mbrojtëse, por duhet të punoj në përmirësimin e performansave dhe informimin e publikut për funksionimin e gjyqësorit.
Përveç se për qytetarët, informacionet duhet të jenë të aksesshme edhe për vet gjyqtarët.

Informacionet që publikohen në ueb-faqe duhet të jenë në kohë, të sakta, të qarta, lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesshme. Nga ana tjetër, Këshilli Gjyqësor duhet të ketë marrëdhënie korrekte me gazetarët dhe profesionistët mediatikë, të cilët janë mjaft të rëndësishmit për informimin e qytetarëve dhe mund të sigurojnë që informacionet nga Këshilli Gjyqësor të arrijnë në mënyrë të kuptueshme dhe të aksesshme deri te qytetarët, me ç'rast do të reduktohen spekulimet e panevojshme.

Llogaridhëni

Sipas Kushtetutës dhe ligjit, Këshilli Gjyqësor i RM është organ autonom dhe i pavarur i gjyqësorit. Sipas Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësorë, Këshillat gjyqësorë janë përgjegjës për aktivitetet e tyre, mes tjerash, edhe me paraqitjen e raporteve periodike publike.[19]

16 Raporti i parë i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor të RM, për periudhën kohore nga nëntori 2016 deri në janar të vitit 2017. I aksesshëm në: http://ihr.org.mk/uploads/IHR%20-%20Izvestaj%2001%20(web)%20MK.pdf.

17 Raporti për punën e Këshillit Gjyqësor të RM për vitin 2016.

18 Ibid.

19 General Assembly of the European Network of Councils for the Judiciary, I aksesshëm në: https://www.encj.eu/images/stories/pdf/opinions/budapestresolution.pdf.

Llogaridhënia e caktuar parashikohet edhe në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RM-së. Këshilli Gjyqësor harton raport vjetor për punën e tij, të cilin duhet t'ia dërgoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të RM-së. Këshilli Gjyqësor raportin duhet t'ua dërgoj të gjitha gjykatave të RM-së. Raporti shpallet publikisht.[20] Ligji nuk ofron mundësi për vlerësimin e raportit nga gjykatat, siç i është dhënë mundësia Kuvendit. Ligji nuk parashikon obligim për shqyrtimin dhe miratimin e raportit nga gjykatat, siç e parashikon obligimin për Kuvendin. Vetëm dërgimi i raporteve deri te gjykatat, pa mundësi për vlerësim dhe diskutim, është transparencë formale-juridike, por jo edhe llogaridhënie thelbësore. Konfirmim i kësaj është edhe rrethana që mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, në përputhje me Ligjin e gjykatave[21], nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar raportin.

Ligji parashikon se "nëse Kuvendi nuk e miraton raportin, kjo do të jetë bazë për inicimin e diskutimit para organeve të cilat i kanë zgjedhur anëtarët e Këshillit Gjyqësor për vlerësimin e punës së tyre në Këshill".[22] Përcaktimi i këtillë i llogaridhënies, lidhur me vendimin e Kuvendit për raportin e dërguar (raporti i miratuar ose i pa-miratuar) nuk është në drejtim të realizimit të funksionit të Këshillit Gjyqësor si garant i pavarësisë së gjyqësorit dhe zbatimit të Parimit kushtetues për ndarjen e pushteteve. Aq më shumë, sepse numri më i madh i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor vijnë nga radhët e gjyqtarëve, ndërsa vetëm 5 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi i RM-së.

20 Neni 135, Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM.
21 Neni 37, Ligji për gjykatat.
22 Ibid.

Raporti i Këshillit Gjyqësor ka të bëjë me punën e gjykatave dhe gjyqtarëve dhe është e papranueshme nga aspekti i llogaridhënies, të njëjtët të mos mund ta shqyrtojnë dhe vlerësojnë, përveç në situata kur Kuvendi nuk e ka miratuar raportin. Nuk është e qartë se cila është baza që gjykatat ta shqyrtojnë dhe ta vlerësojnë vetëm nëse Kuvendi nuk e miraton të njëjtin. Njëkohësisht, cila është nevoja dhe pasojat e veprimit të gjykatave në këtë situatë!?

LLOGARIDHËNIA- Rezyme nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor në periudhën kohore nëntor 2016-shkurt 2018:

- Këshilli Gjyqësor e dërgoi raportin e punës deri te Kuvendi i RM-së. Deri më tani, Raporti nuk është vënë në rend të ditës për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.
- Raporti i Këshillit Gjyqësor, përveç të dhënave të përgjithshme për numrin e zgjedhjes së gjyqtarëve, gjyqtarëve-porotë dhe kryetarëve të gjykatave, gjendjes kadrovike dhe materiale financiare në gjyqësor, nuk përmban të dhëna të tjera konkrete për punën e Këshillit Gjyqësor, sidomos në drejtim të sigurimit të pavarësisë së gjyqësorit.
- Gjatë miratimit të Raportit vjetor për vitin 2016, në mbledhje u diskutua për parametrat sipas të cilëve bëhet notimi i punës së gjykatave. Është konstatuar se numri më i madh i gjykatave, në vitin 2016, janë azhurnuar, por tek të gjitha gjykatat, në masë më të madhe ose më të vogël, shfaqen problemet e njëjtë të cilët në njëfarë mënyre reflektohen në azhurnitetin dhe efikasitetin e gjykatave, ndërkaq që kanë të bëjnë me problemet hapësinore, pajisjet e vjetruara TIK, mospasjen e numrit të mjaftueshëm të nëpunësve administrativ dhe nëpunësve profesional gjyqësor, ndërsa në disa gjykata edhe mospasjen e numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve.
- Në periudhën e kaluar, temë e shpeshtë e diskutimit ishte çështja e përgjegjësisë kolektive ose individuale e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të RM-së.
- Kryetari i Këshillit Gjyqësor kishte numër të rritur të deklaratave për media, komunikata për publikun dhe pjesëmarrje në emisione televizive. Megjithatë, deklaratat dhe komunikatat nuk arritën të japin përgjigje për çështjet më të rëndësishme dhe ta kënaqin interesimin e publikut në kontekst të rritjes së besimit ndaj Këshillit Gjyqësor dhe gjyqësorit në përgjithësi.
- Për shembull, komunikatat për vizitën e gjykatës në Gjevgjeli, si dhe komunikatat të cilat kanë të bëjnë me sistemin AKMIS, të cilat nuk u përgjigjën pyetjeve të parashtruara të gazetarëve, por përkundrazi, përmbajtja e tyre kontribuoi për kritika plotësuese të gazetarëve dhe shkaktoi konfuzion edhe në publik.[23]
- Anëtarët e Këshillit Gjyqësor, me disa përjashtime, nuk u deklaruan për kandidatët gjatë kryerjes së përzgjedhjes, përveç në zgjedhjen e fundit, kur kjo mundësi u shfrytëzua vetëm nga tre anëtarë të Këshillit Gjyqësor.
- Me ndryshimet e muajit dhjetor të vitit 2017, çdo anëtar i Këshillit me të drejtë vote e ka për detyrë që publikisht, në mbledhjen e Këshillit, ta arsyetoj vendimin e tij për zgjedhjen e gjyqtarit.[24]

Këshilli Gjyqësor e pranoi rekomandimin e raportit të tretë të monitorimit për publikimin në kohë dhe të plotë të vendimeve për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat më të larta, i cili u realizua në nëntor të vitit 2017, në të cilin i publikoi të dhënat në bazë të të cilave rankohen gjyqtarët, siç janë pikët e notimit të viteve të stazhit etj,, edhe atë jo vetëm për kandidatin e zgjedhur, por edhe për kandidatët e tjerë të cilët nuk janë zgjedhur.[25]

Llogaridhënia duhet të jetë në interes të publikut, me çka pengohet puna për interesa personale. Llogaridhënia nuk nënkupton vetëm llogaridhënie para një institucioni tjetër por, llogaridhënia është e rëndësishme për qytetarët. Për këtë shkak, Këshilli Gjyqësor i RM-së vendimet dhe aktivitetet e veta duhet t'i orientoj në drejtim të realizimit të interesit publik, me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve në këtë trup dhe me qëllim të reduktimit të ekzistimit të çfarëdo qoftë dyshimi për motivin e vendimmarrjes.

Me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve në këtë trup, është e rëndësishme që qytetarët ta perceptojnë Këshillin Gjyqësor si organ përgjegjës dhe llogaridhënës.

Në mungesë të llogaridhënies thelbësore ndaj qytetarëve, Këshilli Gjyqësor, ndërsa me këtëj edhe sistemi gjyqësor në përgjithësi, mund të konsiderohen si "sisteme të mbyllur", të cilët punojnë në dobi të tyre, dhe jo në të mirën e shoqërisë.

23 Njoftim i KGJRM për vizitën e realizuar të punës në GJTH Gjevgjeli

24 Neni 3, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e RM, nr.197 nga data 29.12.2017

25 Raporti numër 4 i monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit për Përcaktimin e Fakteve. I aksesshëm në: http://ihr.org.mk/uploads/IHR%20-%20Izvestaj%2004%20MAK%20(web)%20(4).pdf

Efektiviteti

Efektivitetin e punës së Këshillit Gjyqësor e përkufizojmë në kontekstin e shkallës së përmbushjes së qëllimeve, për shkak të të cilave ekziston ky organ.

Efektiviteti vlerësohej përmes ndjekjes së kompetencave ligjore të Këshillit Gjyqësor: Zgjedhjes së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, Zgjedhjes së gjyqtarëve-porotë, Shkarkimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave dhe Procedurave të rishpërndarjes së gjyqtarëve (transferimi dhe delegimi i gjyqtarëve).

Si kompetencë e rëndësishme, me të cilën sigurohet pavarësia e gjyqësorit, është zgjedhja e gjyqtarëve, kështu që i tërë procesi i zgjedhjes së gjyqtarëve duhet të jetë transparent për mbikëqyrje publike, meqë publiku ka të drejtë të dijë se si bëhet zgjedhja e gjyqtarëve.

Nga ana tjetër, kandidati i cili/e cila nuk është zgjedhur ka të drejtë ta dijë se pse nuk është zgjedhur dhe duhet të ekzistoj proces i kontestimit të zgjedhjes nga ana e cilido qoftë kandidat i cili nuk është zgjedhur, nëse i njëjti beson se është trajtuar në mënyrë të padrejtë në procesin e emërimit.[26]

Mundësia e ankesës ndaj vendimit për moszgjedhje nuk ishte përcaktuar në mënyrë ligjore dhe Këshilli Gjyqësor nuk kishte kompetencë të veproj sipas ankesave të kandidatëve për gjyqtarë dhe kryetarë të gjykatave të cilët nuk ishin zgjedhur. Me ndryshimet e reja të muajit dhjetor të vitit 2017, kandidatët për gjyqtarë dhe kryetarë të gjykatave të cilët nuk janë zgjedhur kanë të drejtë ankese deri te Gjykata Supreme e RM-së.[27]

Këshilli Gjyqësor i RM-së, në periudhën e monitorimit i përmbushte kompetencat në afatin e përcaktuar me ligj, me ç'rast i publikonte në kohë shpalljet për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve-porotë, kryente vizita të rregullta të gjykatave dhe ngjashëm.[28]

Megjithatë, gjatë notimit të efektivitetit vlerësohet jo vetëm atë që e ka bërë Këshilli Gjyqësor, por edhe atë që nuk e ka bërë, ndërsa sipas notës objektive e ka pasur për detyrë ta bëjë, me qëllim që ta realizoj funksionin e vet kryesor kushtetues – sigurimin e autonomisë dhe pavarësisë së gjyqësorit.

<u>EFEKTIVITETI – Rezyme e monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor në periudhën kohore nëntor 2016-shkurt 2018:</u>

- Këshilli Gjyqësor nuk ndërmori kurrfarë hapash për shqyrtimin e dyshimeve të cilat u shfaqën nga bisedat e prezantuara telefonike për ndikime të palejueshme të pushtetit ekzekutiv mbi përzgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve, si dhe mbi vendimmarrjen e gjyqtarëve dhe nuk e ka notuar, si dhe nuk e ka marrë parasysh sistemin e shpërndarjes së lëndëve në gjykata sipas zgjedhjes së rastit dhe keqpërdorimet e tij të mundshme gjatë notimit të kryetarëve të gjykatave, si dhe ndryshimi i shpeshtë i kalendarit vjetor për punën e gjyqtarëve në disa gjykata (ritransferimi i gjyqtarëve).
- Këshilli Gjyqësor, në muajin shkurt të vitit 2017, iu qas ndryshimeve të Rregullores së punës në dispozitat lidhur me mundësinë e votimit dhe vendosi për përjashtimin e publikut. Për shembull: "Këshilli shqyrton propozim rank-listat e kandidatëve dhe miraton rank-listë përfundimtare të kandidatëve sipas specializimit të nevojshëm, në mbledhje në të cilën publiku mund të përjashtohet me vendim të Këshillit, e që është në kundërshtim me legjislacionin e paraparë me ndryshimet ligjore të muajit dhjetor të vitit 2017.[30]
- Në mbledhjen në të cilën u miratuan ndryshimet dhe plotësimet e Rregullore për punën e KGJRM nuk pati diskutime lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e anëtarëve të KGJRM të cilët ishin të pranishëm në mbledhje.
- Këshilli Gjyqësor lejoi përsëritjen e procedurës kundër gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Shkup, sipas aktgjykimit të miratuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në të cilin është konstatuar shkelje.
- Në periudhën e monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor nuk kishte mundësi të zgjedh gjyqtarë dhe kryetarë të gjykatave, duke filluar nga muaji dhjetor i vitit 2016, për shkak të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare

26 Development of Minimal Judicial Standards Report 2010-2011, European Network of Councils for the Judiciary, faqe 13.

27 Neni 3, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 197 nga data 29.12.2017

28 Gjatë periudhës së kaluar, për shkak të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe sipas rekomandimit të Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit, Këshilli Gjyqësor nuk guxonte të kryej zgjedhje dhe avancime të gjyqtarëve dhe të zgjedh kryetarë të gjykatave. Në disa raste vetëm u emëruan UD kryetarë të gjykatave.

29 Neni 8, Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

30 Me ndryshimet ligjore të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, nga muaji dhjetor 2017, publiku në asnjë rast nuk mund të përjashtohet gjatë zgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë dhe kryetarë të gjykatave.

dhe deri në zgjedhjet lokale të vitit 2017, sipas Rekomandimit të pranuar nga Komisioni Shtetëror për Luftë kundër Korrupsionit.

- Zgjedhja e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave u bë në muajin nëntor të vitit 2017. U miratuan vendime për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të RM – 1 gjyqtar nga fusha penale, në Gjykatën e Apelit Manastir – 1 gjyqtar nga fusha penale, në Gjykatën e Apelit Shkup – 3 gjyqtarë prej të cilëve 1 gjyqtar nga fusha penale dhe dy gjyqtarë nga fusha civile.

Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve për Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit, edhe pse u shpall konkurs për 2 gjyqtarë në Gjykatën Supreme dhe 4 gjyqtarë në Gjykatën e Apelit, ndërkaq edhe pse në konkurs ishin paraqitur 7 gjyqtarë për Gjykatën Supreme dhe mbi 50 gjyqtarë për Gjykatën e Apelit, të cilët i plotësonin kushtet konform Ligjit, megjithatë, për gjyqtarë të Gjykatës Supreme është zgjedhur vetëm një gjyqtar edhe atë nga lista e kandidatëve sipas parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, edhe pse kishte nevojë për dy gjyqtarë, ndërsa në Gjykatën e Apelit, nga 4 gjyqtarët sa nevojiteshin, janë zgjedhur tre gjyqtarë. Për veprimin e këtillë, KGJRM-ja nuk dha arsyetim për shkaqet e zgjedhjes jo të plotë të gjyqtarëve sipas konkurseve. Vetëm një muaj më vonë, pak para se të hyjnë në fuqi ndryshimet ligjore, me të cilat për herë të parë kandidatëve të cilët nuk janë zgjedhur për gjyqtarë iu mundësua e drejta e ankesës, Këshilli Gjyqësor përsëri shpalli konkurs për zgjedhjen e gjyqtarëve në këto dy gjykata. Procedura për këto vende të njëjta vakante për gjyqtarë, pa nevojë, për herë të dytë, tanimë zgjatë disa muaj. Në këtë mënyrë, si bartës të funksionit publik, duke e zbatuar në mënyrë joefektive kompetencën për zgjedhjen e gjyqtarëve, anëtarët e Këshillit Gjyqësor shkaktojnë më shumë pasoja të cilat ndikojnë në besimin e qytetarëve ndaj gjyqësorit.

Transparenca e punës së KGJRM

Transparenca është parim i cili në një shoqëri demokratike duhet të siguroj që proceset e vendimmarrjes të organeve dhe pushtetit publik të jenë sa më pranë qytetarëve, në mënyrë që ata të kenë këqyrje në lidhje me atë nëse organet i kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të mirëfilltë. Në këtë kontekst, transparenca e reflekton natyrën demokratike të institucioneve dhe besimin publik në kryerjen e funksioneve, si kusht i domosdoshëm i legjitimitetit të tyre. Ky parim i tejkalon format dhe instrumentet e njohura të kontrollit politik ose juridik e që u përket organeve të sistemit të ndarjes së pushteteve në një shoqëri demokratike dhe fuqizohet si instrument i publikut në kuptimin e plotë, i cili apelon për llogaridhënie, për shkak se publiku "ka të drejtë të dijë", por edhe të participoj.

Është me rëndësi të theksohet se në debatin e realizuar publik, përkushtuar transparencës së Këshillit Gjyqësor, nga këndvështrimi i gazetarëve u vërejt pakënaqësia e gazetarëve lidhur me transparencën e Këshillit Gjyqësor. Transparenca e KGJRM, nga këndvështrimi i gazetarëve, është në nivel të pakënaqshëm, me ç'rast u theksua se informacionet të cilat i pranojnë gazetarët nga Këshilli Gjyqësor nuk e kënaqin interesin publik.

Transparenca, si parim, veçanërisht fitoi në peshë në funksionimin e institucioneve të BE si formë e baj-pasimit të të ashtuquajturit "deficit demokratik" në konstituimin e trupave drejtues të Bashkimit.[31] Së këtejmi, përkufizime të rëndësishme të transparencës hasen pikërisht në diskutimet dhe materialet para Gjykatës së BE, të cilave do t'ju referohemi edhe në këtë tekst. Nga ana tjetër, ky parim është sanksionuar edhe në dokumentet relevante të trupave ndërkombëtare konsulente nga sfera e gjyqësorit (jurisprudencës). Nga ana tjetër, në Opinionin numër 10 të Këshillit Konsulent të Gjyqtarëve Evropianë të vitit 2007 theksohet se "doemos duhet të ekzistoj transparencë e plotë e kushteve për zgjedhjen e kandidatëve, me qëllim që gjyqtarët dhe shoqëria në përgjithësi të sigurohen se emërimi bazohet ekskluzivisht mbi vlerën e kandidatëve dhe kualifikimeve të tyre, aftësive, integritetit, perceptimit të pavarësisë, paanshmërisë dhe efikasitetit. Prandaj, me rëndësi esenciale është që ... emërimi dhe kriteret për seleksionim të jenë të arritshme deri te publiku i gjerë".[32]

31 Vasiliki (Vicky) Karageorgou, Transparency principle as an evolving principle of EU law: Regulative contours and implications, http://www.right2info.org/resources/publications/eu-karageorgou-vasiliki-transparency-principle-as-an-evolving-principle-of-eu-law

32 Opinion no.10(2007) of the Consultative Council of European Judges (CCJE), https://rm.coe.int/168074779b

Në raportin për pavarësinë e sistemit gjyqësor nga viti 2010 Komisioni i Venecias, në pikën 25 thekson se, mes tjerash, me rëndësi esenciale është që gjyqtari të ketë sens për drejtësi dhe veprim të ndershëm, megjithatë gjatë vlerësimit të kritereve të këtilla nevojitet procedurë transparente dhe praktikë koherente".[33]

Këto të dhëna e implikojnë rëndësinë e aspektit thelbësor të transparencës – publiku t'i perceptoj bazat dhe shkaqet për vendimet të cilët i miratojnë trupat kompetentë për zgjedhjen ose emërimin e gjyqtarëve, siç është Këshilli Gjyqësor.

Sipas një përkufizimi, transparenca ka të bëjë me cilësinë e të qenit të qartë, evident dhe të kuptueshëm, pa dyshime ose kundërthënie. Transparenca nënkupton "të dihen motivet" e vendimit, përkatësisht shkaqet e tij.

Kur bëhet fjalë për Këshillin Gjyqësor, funksioni bazë kushtetues i të cilit është ta siguroj pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit i cili i shqipton aktgjykimet në emër të qytetarëve, është e qartë se me interes thelbësor për publikun është të dijë nëse vendimet e Këshillit Gjyqësor, për zgjedhjen dhe karrierën e gjyqtarëve, bazohen mbi vlerën e tyre, me zbatimin e kritereve objektive në kuadër të Ligjit.[36]

Nënkuptohet, transparenca është parim kompleks që përfshin edhe elementë të tjerë të rëndësishëm, siç janë transparenca e punës së Këshillit Gjyqësor, për shembull në mbledhjet, publikimi i informacioneve për aktivitete ose njoftime për efektet e aktiviteteve të tilla, qasja në dokumente, liferimi i raporteve për punë dhe ngjashëm. Megjithatë, edhe pse bëhet fjalë për elementë të rëndësishëm, transparenca, si parim, nuk mund të mbështetet në to, apo vetëm në disa prej tyre.

Për shembull, transparenca e mbledhjes së Këshillit Gjyqësor për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatë më të lartë, për përfaqësuesit e mediave ose për organizatat profesionale gjithsesi se është presupozim i rëndësishëm për realizimin e punës transparente, megjithatë, mbledhja nuk do ta përmbush parimin e transparencës nëse në të publiku i pranishëm nuk ka mundësi t'i dëgjojë shkaqet e miratimit të vendimit për zgjedhje, sidomos kur vendoset midis më shumë kandidatëve.

Kuptohet, publikimi i shpalljes së zgjedhjes, publikimi i caktimit të mbledhjes në të cilën do të bëhet përzgjedhja dhe transparenca e mbledhjes për publikun nuk janë të diskutueshme dhe duket se tashmë janë të pakontestueshme si rutinë e Këshillit Gjyqësor.

Ajo që është problematike, nga njëra anë, rezulton nga legjislacioni pamjaftueshëm i qartë në lidhje me kriteret për zgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve, si dhe nga qasja e anëtarëve të procesit Gjyqësor në procesin e miratimit të vendimeve, nga ana tjetër.

Në nenin 46 të Ligjit për gjykata parashikohet se në gjykatat më të larta mund të zgjidhet person i cili ka përvojë të caktuar pune si gjyqtarë në gjykatën më të ulët, i cili, vitin e fundit, nga ana e Këshillit Gjyqësor është notuar me notën më të lartë pozitive dhe në raport me personat e tjerë të paraqitur ka fituar numrin më të madh të pikëve. Sipas kësaj dispozite, duket se nota më e lartë dhe numri më i madh i pikëve janë vendimtare, përkatësisht kriteri i vetëm për zgjedhje.

Metodologjia dhe kriteret e fitimit të pikëve, padyshim i janë lënë Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Megjithatë, krahas kësaj, metodologjia e pikëve (tek monitorimi i punës së gjyqtarëve, e rregulluar në nenet 98-131), në nenin 41 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor janë parashikuar kritere plotësuese të zgjedhjes, të cilat në çdo rast kanë të bëjnë me aspektet thelbësore të kryerjes së funksionit të gjyqtarit, por në mënyrë efektive e vënë në

33 CDL-AD(2010)004-e, Report on the Independence of the Judicial System Part I: The Independence of Judges adopted by the Venice Commission at its 82nd Plenary Session (Venice, 12-13 March 2010), http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2010)004-e

34 Opinion of AG Ruiz-Jarabo Colomer of 16 December 2004 in C-110/03 Belgium v. Commission, 2005, ECR I-2801, point 44.

35 A.v. Bogdandy, Doctrine of Principles, Jean Monnet Working Paper 9/03, available at: http://centers.law.nyu.edu/jeanmonnet/archive/papers/03/030901-01.pdf

36 Supra note 3, t, 27.

pikëpyetje zbatueshmërinë e dispozitës së nenit 46 të Ligjit për gjykata.[37]

Përfundimisht, në nenin 21 të Rregullores së Këshillit Gjyqësor përcaktohet se për kandidatët votohet sipas radhës së rank-listës e cila është përpiluar sipas pikëve të parashikuara në Ligjin për Këshillin Gjyqësor, me ç'rast është e mundur të zgjidhet kandidati i cili është në vendin e fundit të rank-listës, përkatësisht i cili nuk e ka numrin më të madh të pikëve, e as notën më të lartë pozitive, siç e parashikon neni 46 i Ligjit për gjykata.

Kjo gjendje ka tre aspekte të rëndësishme. **Aspekti i parë** ka të bëjë me çështjen e konsistencës juridike të rregullimit të kritereve për notimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve në dy ligje, të cilët miratohen me shumicë të ndryshme në Parlament, të sanksionuar në Kushtetutë. Kundërthëniet evidente në përpjekjet që kriteret të pasqyrohen si komplementare, janë vështirësi jo vetëm për anëtarët e Këshillit Gjyqësor, por veçanërisht për publikun, i cili nuk mund lehtësisht të vlerësoj se cili është spektri i vërtetë i kritereve të cilët e përcaktojnë zgjedhjen objektive të kandidatëve më të mirë. Kjo, vetvetiu, është mungesë kualitative e transparencës. **Aspekti i dytë** ka të bëjë me kualitetin dhe relevancën e kritereve për rankimin e kandidatëve sipas skemës së pikëve, të parapara me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, e që ishte objekt i kritikave serioze të Komisionit të Venecias.[38] I njëjti në mënyrë objektive detekton se kriteret ligjore për notimin e gjyqtarëve, e që më pas është bazë për rankimin e tyre, janë mjaft kuantitativ dhe nuk sigurojnë notë të aspekteve thelbësore dhe aspekteve të ndryshme të kualitetit të kryerjes së funksionit të gjyqtarit. Në këtë mënyrë, vlera e nenit 46 të Ligjit për gjykata, i cili kërkon zgjedhje sipas pikëve, e që do të duhej të duket si kriter i objektivizuar, komprometohet seriozisht, sepse insistimi i këtyre pikëve, në fakt, çon deri në favorizimin e kritereve kuantitative dhe formale, në vend të kritereve kuantitative dhe thelbësore. **Aspekti i tretë** i kësaj gjendjeje mundëson që zgjedhja e gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës të bëhet përmes votimit dhe numërimit të votave, në vend të demonstrimit transparent të shkaqeve thelbësore dhe relevante të vendimit për zgjedhje. E gjithë kjo, në mënyrë inherente e komprometon procesin e përgjithshëm zgjedh.

Megjithatë, edhe në situatë të këtillë të palakueshme ligjore, publiku ka të drejtë të pres nga Këshilli Gjyqësor të mos e bëjë zgjedhjen e gjyqtarëve vetëm me votim, por t'i sqaroj dhe t'i arsyetoj vendimet e tij dhe në mënyrë bindëse, të dëshmojë se janë zgjedhur kandidatët më të mirë.

Anëtarët e Këshillit Gjyqësor të RM zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave e bënin pa debat thelbësor dhe relevant në mbledhjet për vlerën e çdo kandidati veç e veç, që do të pasqyronte se cili ose cilët kandidatë janë më të mirë se të tjerët dhe pse. Gjithashtu, në vendimet për zgjedhje, arsyetimi është se kandidati i zgjedhur i përmbush kushtet e parashikuara me ligj, pa sqarime se cilat kualitete i veçojnë kandidatët e zgjedhur nga kandidatët e tjerë. Në periudhën e kaluar, në vendime publikohet edhe rank-lista e kandidatëve me pikë të përcaktuara dhe me të dhëna biografike, e që gjithsesi e përmirëson transparencën, megjithatë kjo nuk do të thotë asgjë nëse në vendim nuk mund të shihet se cilat kritere kanë qenë vendimtare për shumicën e anëtarëve të Këshillit gjatë përzgjedhjes së kandidatit konkret para të tjerëve. Pa këtë, publiku mbetet i mangët për "t'u njoftuar me motivet" e vendimit, i mangët për vendim "të qartë, jo kundërthënës dhe të drejtë". Kjo, veçanërisht është e rëndësishme nëse merret parasysh fakti se Këshilli Gjyqësor ka miratuar vendime për zgjedhjen e kandidatëve me numër më të madh të pikëve, megjithatë, edhe me numër më të vogël të pikëve nga të tjerët, e që e imponon nevojën për justifikim racional dhe thelbësor edhe në njërën situatë edhe në situatën tjetër.

Në lidhje me këtë, përgjigjja që kryetari i Këshillit Gjyqësor e jep në pyetjen e gazetarëve, se është zgjedhur një kandidat i caktuar sepse "ashtu ka vendosur shumica" nuk i shërben parimit të transparencës. I papranueshëm është vendimi që të justifikohet se kështu ka votuar shumica, ndërsa kandidati i zgjedhur i plotëson kushtet e parapara me ligj (edhe kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur i plotësojnë kushtet!), pa dhënë arsyetim se cilat janë shkaqet që e kanë përcaktuar shumicën e anëtarëve të Këshillit të votojnë pikërisht për atë kandidatë në raport me kandidatët e tjerë.

37 Ligji për gjykata miratohet me dy të tretat e shumicës së votave në Kuvend, ndërsa Ligji për Këshillin Gjyqësor me shumicë të absolute;

38 CDL-AD(2015)042-e, Opinion on the Laws on the Disciplinary Liability and Evaluation of Judges of "The Former Yugoslav Republic of Macedonia", adopted by the Venice Commission at its 105th Plenary Session (Venice, 18-19 December 2015), http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2015)042-e

39 Independent Senior Experts' Group, The former Yugoslav Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, 8 June 2015, f. 10 paragrafi 1, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/newsfiles/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf

Ky është një faktor thelbësor për sa i përket vlerësimit për atë se Këshilli Gjyqësor është jotransparent në funksionin e tij kryesor kushtetues. Shqetëson fakti se jo-transparenca e kësaj procedure u detektua dhe u sanksionua që në Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve, i udhëhequr nga Rajhard Pribe nga 8 qershori të vitit 2015[39], në të cilat në mënyrë të veçantë u konstatua se nuk bëhet krahasimi i vlerës së kandidatit, dhe pas dy vitesh Grupi i njëjtë i ekspertëve në Vlerësimin dhe Rekomandimet e 14 shtatorit të vitit 2017[40] konstatoi se nuk është arritur kurrfarë progresi dhe se Këshilli Gjyqësor, përkatësisht anëtarët e tij, edhe më tutje zgjedhjen e bëjnë pa obligim që ta arsyetojnë vendimin e tyre. Arsyetim nuk ekziston as në rastin kur nuk zgjidhet asnjëri nga kandidatët e paraqitur për gjyqtarë ose për kryetar gjykate, e që është indikative për motivet e Këshillit, por ka edhe pasoja negative mbi punën e gjykatave, veçanërisht kur nuk zgjidhet kryetari i gjykatës.

Së këtejmi, është e qartë se besimi i nevojshëm dhe i dëshiruar i publikut të gjerë por edhe atij profesional ndaj Këshillit Gjyqësor, si faktor dhe garant i pavarësisë dhe autonomisë së gjyqësorit, realisht nuk mund të pritet në pjesën e kompetencës për zgjedhje, përkatësisht avancimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.

Transparenca e zgjedhjes së gjyqtarëve është e rëndësishme edhe nga pikëpamja e kandidatëve të cilët nuk janë zgjedhur. Edhe ata, sikurse edhe publiku, kanë pritshmëri legjitime se procesi i zgjedhjes do të realizohet në mënyrë transparente, sipas kritereve të përcaktuara dhe konform notës së tyre objektive dhe të arsyetuar nga ana e Këshillit Gjyqësor, por edhe ajo se kandidatura e tyre do të shqyrtohet seriozisht. Kjo, aq më shumë është e rëndësishme nëse merret parasysh se legjislacioni ynë nuk parashikonte mundësi për mbrojtje gjyqësore të ligjshmërisë së vendimit për zgjedhjen e gjyqtarit.[41]

Kërkesat e disa kandidatëve të pazgjedhur që të rishikohet vendimi për zgjedhje si i paligjshëm, adresuar Këshillit Gjyqësor, thjeshtë janë hedhur poshtë (rregull formal), për shkak të jokompetencës së Këshillit.

Me ndryshimet e reja të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, të cilat hynë në fuqi në dhjetor të vitit 2017,[42] pritet që këto mangësi të evitohen. Ndryshimet parashikojnë: "Çdo anëtar i Këshillit me të drejtë vote, e ka për detyrë publikisht, në mbledhje të Këshillit, ta arsyetoj vendimin e tij për zgjedhjen e gjyqtarit. Këshilli e ka për detyrë ta njoftoj me shkrim çdo kandidat për vendimin e zgjedhjes së gjyqtarit. Kandidati, i cili nuk është zgjedhur për gjyqtar ka të drejtë ankese në afat prej tetë ditësh nga pranimi i njoftimit deri në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë."[43]

Mbledhjet, në të cilat u bë notimi i gjyqtarëve dhe i kryetarëve të gjykatave, në periudhën e kaluar ishin të mbyllura për publikun. Baza për një gjë të këtillë është në dispozitën e nenit 129 të ligjit për Këshillin Gjyqësor, sipas së cilës vendimi për notimin e gjyqtarit dhe kryetarëve të gjykatave është i karakterit konfidencial. Megjithatë, varshmëria e procesit të zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat më të larta dhe e kryetarëve të gjykatave nga notimi i tyre i rregullt apo i jashtëzakonshëm, implikon se ky proces, njësoj si edhe zgjedhja, duhet të jetë transparent. Me inkorporimin e "konfidencialitetit" të notimit, me sa duket, bëhet një përjashtim problematik nga parimi ligjor sa i përket transparencës së punës së mbledhjeve.

Në përputhje me nenin 33 të Ligjit, mbledhjet e Këshillit Gjyqësor mund të jenë të mbyllura për publikun vetëm për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe integritetit të gjyqtarit ose të kandidatit për gjyqtar, por për një gjë të këtillë duhet të ekzistojnë baza objektive dhe serioze. Notimi i gjyqtarëve, të cilët gjykojnë në emër të qytetarëve, realizohet sipas kritereve të përcaktuara me ligj dhe është vështirë të kuptohet se çfarë implikimesh ndaj reputacionit dhe integritetit të tyre mund të ketë diskutimi në lidhje me atë se çfarë note do të marrin, që mbledhja të jetë e mbyllur për publikun, kur tanimë pikët e fituara në këtë bazë janë transparente në procedurën e zgjedhjes.

Transparenca e procesit të notimit mund ta mbështes edhe transparencën e rankimit të tyre dhe zgjedhjen përfundimtare në kuptimin e plotë. Vendimet cilësore, në një proces të këtillë transparent, janë faktor kyç për fitimin e besimit të publikut.

40 The former Yugoslav Republic of Macedonia: Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues 2017, 14 September 2017, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

41 Neni 36 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor;

42 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM, "Gazeta Zyrtare e RM", nr. 197 nga data 29.12.2017

43 Ibid.

Transparenca e procesit të notimit të gjyqtarëve me notë më të lartë ose më të ulët nuk e rrezikon reputacionin dhe integritetin e gjyqtarit, por mund të jetë një indikator transparent në lidhje me atë se me çfarë suksesi e ushtron funksionin e gjyqtarit në interes të qytetarëve. Avancimi i gjyqtarëve, përkatësisht zgjedhja e tyre në gjykatë më të lartë, nuk ka të bëjë vetëm me karrierën e tyre, por është në interes publik për sigurimin e standardeve më të larta të mundshme lidhur me profesionalizmin, pavarësinë dhe paanshmërinë gjatë ndarjes së drejtësisë. Transparenca e plotë e këtij procesi nuk mund t'i dëmtoj qëllimet e tij.

Në lidhje me këtë duhet të nënvizohet se Këshilli Gjyqësor, me ndryshimin e Rregullores në shkurt të vitit 2017, përcaktoi se mund të vendos që mbledhjet të jenë të mbyllura për publikun në të cilat merret vendimi për miratimin e rank-listës përfundimtare gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, edhe pse është vështirë të kuptohet se si vendimmarrja për këtë çështje mund ta rrezikoj reputacionin dhe dinjitetin e kandidatëve.

Me ndryshimet e fundit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, nga muaji dhjetor i vitit 2017 anulohet kjo mundësi e parashikuar me Rregulloren. Ndryshimet e reja parashikojnë se "Kur Këshilli vendos për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës ose për zgjedhjen e gjyqtarit, publiku nuk mund të përjashtohet në asnjë rast."[44]

Konform Ligjit, mbledhjet, në të cilat vendoset për shkarkimin e gjyqtarëve ose për përgjegjësi disiplinore, janë të mbyllura për publikun. Megjithatë, Këshilli Gjyqësor do të vendos që mbledhja të jetë publike kur një gjë të këtillë do ta kërkoj gjyqtari kundër të cilit zhvillohet procedura.[45] Interpretimi i këtyre dispozitave nga Këshilli Gjyqësor për atë se mbledhja do të jetë transparente vetëm nëse kështu vendos Këshilli, madje edhe përkundrejt kërkesës së gjyqtarit kundër të cilit zhvillohet procedura, konsiderojmë se është jopërkatëse.

Individi është zot i të drejtës që ta mbroj reputacionin dhe integritetin, e që është bazë edhe për autorizimin e të prekurit të kërkoj që mbledhja të jetë publike. Përveç kësaj, edhe procedura disiplinore, si edhe procedura për shkarkim për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit, trajtohen konform nenit 6 të Konventës, kështu që refuzimi i kërkesës së gjyqtarit që mbledhja të jetë transparente e tangon, në atë kontekst, në "debatin publik".

Në situata të këtilla, prezenca e publikut do të ishte një faktor i jashtëzakonshëm i demokracisë së ligjshmërisë, paanshmërisë dhe pavarësisë së punës profesionale të Këshillit Gjyqësor. **Prandaj sugjerohet, Këshilli Gjyqësor detyrimisht të marr vendim për mbajtjen e mbledhjes publike çdoherë kur gjyqtari, përkatësisht kryetari i gjykatës, kundër të cilit zhvillohet procedura, e kërkon një gjë të këtillë. Në këtë mënyrë do të përmirësohet pozicioni i gjyqtarit në procedurën e mëtutjeshme për mbrojtjen gjyqësore kundër vendimit të Këshillit.**

Nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor, i zbatuar në kuadër të këtij projekti, mund të shihet se transparenca, e matur sipas indikatorëve të miratuar, mund të vlerësohet si relativisht e kënaqshme në lidhje me publikimin e dokumenteve dhe llojin e tyre në Ueb-faqen e Këshillit (komunikata për mbledhjet e konvokuara, për vendimet, raportet vjetore të Këshillit Gjyqësor, përfshirë këtu edhe raportet tremujore për punën e gjykatave, të cilat për herë të parë filluan të publikohen kah fundi i vitit 2017), por, megjithatë, një pjesë e dokumenteve nuk publikohen në kohë ose publikohen në fushë jopërkatëse të faqes, siç është rasti me dokumentin për prokurime publike i cili është vendosur në fushën për lajme dhe jo në fushën ekzistuese për prokurime publike.

Procesverbalet e mbledhjeve nuk publikohen, por informacionet bazike për vendimet dhe konkluzionet e miratuara, publikohen përmes komunikatave për vendimet e miratuara.

Ueb-faqja e re e Këshillit Gjyqësor, në portalin gjyqësor, nuk siguron navigacion dhe akses të lehtë deri te informacionet. Nevojitet përpjekje e vogël, e natyrës teknike, që këto mangësi të evitohen, me ç'rast në masë të konsiderueshme do të lehtësohet aksesi deri te informacionet e ueb-faqes, të rëndësishme për monitorimin e punës së tij.

44 Neni 2 i Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM, "Gazeta Zyrtare e RM", nr. 197 nga data 29.12.2017.
45 Neni 54 dhe neni 78 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor

Llogaridhënia e punës së KGJRM

Llogaridhënia nënkupton detyrë të Këshillit Gjyqësor të jap llogari për punën e tij. Parimi i llogaridhënies së Këshillit Gjyqësor është sanksionuar në paragrafin 3 të Amendamentit XXIX të Kushtetutës, sipas të cilit, Këshilli, për punën e tij paraqet raport vjetor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, forma, përmbajtja dhe mënyra e miratimit të të cilit rregullohen me ligj. Së këtejmi, Kushtetuta gjithsesi se implikon një formë të caktuar të kontrollit demokratik mbi punën e Këshillit nga ana e organit përfaqësues të qytetarëve, e që në mënyrë të pashmangshme e përfshin edhe mundësinë për marrjen e ndonjë qëndrimi të caktuar, pozitiv ose negativ, për punën e tij.

Raportet vjetore të cilat i miraton Këshilli Gjyqësor përfshirë këtu edhe raportin e vitit 2016,[46] i përmbajnë të dhënat e përcaktuara me ligj, siç është numri i gjyqtarëve të zgjedhur dhe të shkarkuar dhe të gjyqtarëve-porotë, numri i procedurave disiplinore, gjendja kadrovike dhe materiale-financiare, numri i lëndëve, bashkëpunimi me organe të tjera, megjithatë këto kryesisht japin informacione statistikore.

Në Raportet vjetore nuk mund të shihen informacione, për shembull, për tentativa të vërejtura për ndikim ose presion mbi gjyqtarët, si dhe mënyrën e ballafaqimit të Këshillit Gjyqësor me dukuri të kësaj natyre për shkak të mbrojtjes së autonomisë dhe pavarësisë së gjyqësorit, edhe pse në vitin 2015 dhe 2016 nuk është se mungonin indikacione, madje edhe të dhëna kredibile për atë se ekzistojnë dukuri të këtilla, madje edhe brenda në gjyqësor.

Megjithatë, raportet vjetore janë një bazë e mjaftueshme për debat parlamentar, për sqarimin e informacioneve dhe çështjeve të përfshira me raportin, por edhe për ato që nuk janë përfshirë me të njëjtin, ndërkaq janë të rëndësishme për autonominë dhe pavarësinë e gjyqësorit, si dhe për ndërtimin e besimit publik ndaj sistemit gjyqësor. Për fat të keq, në Kuvend, raportet e Këshillit Gjyqësor nuk zgjojnë interesim dhe debat, ndërkaq me sa duket e njëjta vlen edhe për gjykatat të cilave u dërgohet ky raport dhe për të njëjtin, konform ligjit, gjykatat nuk kanë obligim të debatojnë.

Përveç raportit vjetor, si instrument kryesor i llogaridhënies vërehen edhe forma të tjera të llogaridhënies të cilat praktikohen kohëve të fundit, veçanërisht përmes komunikatave të kryetarit të Këshillit Gjyqësor pas mbajtjes së mbledhjeve, i cili u përgjigjet pyetjeve të përfaqësuesve të mediave, merr pjesë në emisione debative nëpër televizione dhe në debate profesionale.

Në ligj nuk ekziston mundësia për shkarkimin e anëtarit të Këshillit Gjyqësor ose të këshillit në tërësi edhe atë mbi asnjë bazë, e që në publik, përfshirë këtu edhe publikun profesionistë, nuk mund të kuptohet dhe të pranohet. Edhe pse një gjë e këtillë është jokonsistente me pozitën e theksuar kushtetuese për kontroll demokratik të Këshillit Gjyqësor, megjithatë, ky pozicion nuk është lënë pa ndonjë kuptim. Shqyrtimi i raportit në Kuvend hap mundësi për trajtimin e punës individuale dhe kolektive të anëtarëve të Këshillit me implikime për përgjegjësi të tyre. Me fjalë të tjera, konform nenit 135 të Ligjit, nëse Kuvendi nuk e miraton raportin vjetor për punën e Këshillit, kjo do të jetë bazë për hapjen e debatit para organeve të cilat i kanë zgjedhur anëtarët e Këshillit Gjyqësor për **vlerësimin e punës së tyre**. Në lidhje me këtë, duhet të merret parasysh edhe neni 36 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor, sipas të cilit anëtari i Këshillit Gjyqësor është përgjegjës për shkeljen e Kushtetutës dhe ligjit gjatë kryerjes së funksionit. Këto dy dispozita gjithsesi se duhet të interpretohen si komplementare. Ligji pa ekuivoke e përcakton normën se anëtari i Këshillit është përgjegjës për shkeljen e Kushtetutës dhe ligjit, e që gjithsesi nuk mund të përjashtohet si çështje e vlerësimit të punës së tij në rast të mosmiratimit të Raportit. Konstatimi i shkeljes së kushtetutës ose ligjit nga ana e një anëtari, nga më shumë anëtarë ose nga të gjithë anëtarët e Këshillit, nga ana e organit, përkatësisht organeve që i kanë zgjedhur, nëse jo diç më shumë, në këtë kuptim mund të jetë bazë për miratimin e vendimit deklarator, pa efekt juridik për shkarkim.

Në rrethanat aktuale, nëse konstatohet se Këshilli Gjyqësor, në të vërtetë, nuk i ka kryer funksionet e tij më të rëndësishme kushtetuese dhe ligjore, dhe nga kjo kanë rezultuar pasoja të rënda ndaj reputacionit të gjyqësorit dhe besimit të qytetarëve në gjyqësor një vendim i këtillë deklarator do të kishte peshë të njëjtë.

46 Shih në: www.sud.mk

Efektiviteti i punës së KGJRM

Përmes realizimit të funksioneve të tij, në përputhje me Kushtetutën e RM-së dhe ligjet, Këshilli Gjyqësor e siguron dhe garanton autonominë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.[47]

Efektiviteti i punës së Këshillit Gjyqësor vlerësohet përmes monitorimit të kompetencave ligjore gjatë zbatimit të proceduarave për:

- **Zgjedhje të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave**
- **Zgjedhje të gjyqtarëve-porotë**
- **Transferim dhe delegim të gjyqtarëve**
- **Shkarkim të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave**

Megjithatë, efektiviteti i punës së Këshillit Gjyqësor matet jo vetëm në bazë të asaj që ai e ka bërë, por edhe në bazë të asaj se çka nuk ka bërë, ndërkaq sipas vlerësimit objektiv dhe të përgjithshëm e ka pasur për detyrë ta kryej për shkak të përmbushjes së funksionit të tij themelor – sigurim të autonomisë dhe pavarësisë së gjyqësorit.

Monitorimi dëshmon se Këshilli Gjyqësor i kryen punët në kompetencë të tij, të cilat në Ligj specifikohen si obligime konkrete, në një dinamikë të përcaktuar kohore. Në këtë kuptim, Këshilli Gjyqësor shpall konkurse për zgjedhje dhe zbaton procedurë për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, bën notimin e rregullt të gjyqtarëve, zbaton procedurë me kërkesë të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve, megjithatë, pas suspendimit të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe pas miratimit të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor 29.12.2017, kjo procedurë hapet me kërkesë të anëtarit të Këshillit, kryetarit të gjykatës, kryetarit të gjykatës më të lartë ose në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme shqyrtohen raportet për punën e gjykatave, shqyrtohet transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve, miratohet Raporti vjetor për punën e tij, etj.

Megjithatë, nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor të RM-së mund të konstatohen një sërë dobësish në realizimin e kompetencave të tij, ndërkaq me këtë edhe lëshime me rëndësi esenciale gjatë realizimit të funksionit të tij themelor për sigurimin e garancisë dhe mbrojtjen e autonomisë dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor, e cila buron edhe nga Kushtetuta e RM.

Një pjesë e këtyre dobësive, e që janë pengesë për rezultate solide gjatë punës së Këshillit Gjyqësor, janë të natyrës objektive për shkak të zgjidhjeve jopërkatëse dhe pamjaftueshëm precize ligjore, megjithatë, sjellja pasive ndaj dukurive të caktuara dhe sjellja jopërkatëse ndaj obligimit të detyrueshëm për kryerjen e funksionit kryesor, në asnjë mënyrë, nuk mund të arsyetohen, e as të mbeten të pavërejtura nga publiku i cili do ta vlerësoj efektin e tyre negativ në lidhje me cenimin e autoritetit dhe besimin e qytetarëve ndaj gjyqësorit në përgjithësi.

47 Neni 2 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor

Zgjedhja e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave

Këshilli Gjyqësor e bën zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave. Në kuadër të kësaj kompetence, ai fillimisht miraton vendim për përcaktimin e numrit të vendeve vakante për gjyqtarë në gjykatat themelore të shtetit. Ky vendim miratohet me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote.

Pas boshatisjes së vendit për gjyqtar ose pas nevojës së përcaktuar për vendin e gjyqtarit, po ashtu, merret vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e gjyqtarit në një fushë të specializuar, sipas kërkesës së paraqitur nga gjykata.[48]

Këshilli Gjyqësor zgjedhjen e gjyqtarit në Gjykatën Themelore e bën nga rank-lista e kandidatëve të paraqitur nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë që janë paraqitur në konkurs edhe atë sipas radhës konform rezultatit të arritur të përcaktuar në rank-listën përfundimtare.[49]

Mënyra e këtillë e zgjedhjes së gjyqtarit nuk i lë mundësi Këshillit Gjyqësor t'i zbatoj kriteret për kryerjen e zgjedhjes, por puna e tij ka të bëjë me zgjedhjen formale e që i ngjason emërimit të kandidatit për gjyqtar.

Kjo e vë në dukje nevojën e saktësimit të akteve normative sa i përket zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat themelore.

Në kuadër të kompetencës së tij për zgjedhjen e gjyqtarëve, Këshilli Gjyqësor zgjedh edhe gjyqtarë në gjykata më të larta **(Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë Administrative dhe Gjykatën Supreme të RM).**

Për zbatimin e drejtë të procedurës për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat më të larta, Këshilli Gjyqësor formon komision prej tre anëtarësh i cili i kontrollon dokumentet e kandidatëve, e përgatit listën e kandidatëve, i njofton kandidatët për ditën dhe orën e zbatimit të testit psikologjik dhe testit të integritetit, si dhe për kompensimin financiar për ato tekste, i cili është në barrë të kandidatëve, realizon intervista me kandidatët të cilët i kanë kaluar testet dhe e përpilon rank-listën përfundimtare sipas specializimit të nevojshëm, si dhe rank-listën e kandidatëve të cilët nuk e posedojnë specializimin e nevojshëm.

Për zgjedhjen e gjyqtarit, Këshilli Gjyqësor diskuton dhe merr vendim në mbledhje në të cilën marrin pjesë më së paku dy të tretat e anëtarëve me të drejtë vote.

Diskutimi dhe vendimmarrja bëhet me radhë, në përputhje me rank-listën përfundimtare të kandidatëve, ndërkaq çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të prononcohet për kandidatin para se të zbatohet votimi.

Kjo mundësi e prononcimit për kandidatët nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor, një kohë të gjatë nga periudha e monitorimit, nuk praktikohej fare gjatë kryerjes së zgjedhjes, përveç në zgjedhjen e fundit, kur kjo mundësi u shfrytëzua vetëm nga disa anëtarë të Këshillit Gjyqësor të cilët më së shpeshti marrin pjesë në punë.

Me ndryshimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor nga 29.12.2017, kjo dilemë është zgjidhur në atë mënyrë që çdo anëtar i Këshillit me të drejtë vote e ka për detyrë publikisht, në mbledhje të Këshillit, ta arsyetoj vendimin e tij, si për zgjedhjen e gjyqtarit ashtu edhe për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës[50].

Si i zgjedhur konsiderohet ai kandidat i cili ka fituar dy të tretën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Këshilli Gjyqësor e zbaton edhe procedurën për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës, e cila fillon me shpalljen e konkursit dy muaj para skadimit të mandati të kryetarit ekzistues.

Në rast të ndërprerjes së mandatit të kryetarit të gjykatës ose të shkarkimit të të njëjtit, Këshilli Gjyqësor përcakton ushtrues detyre kryetar nga **radhët e gjyqtarëve të gjykatës**, i cili është notuar me notë më të lartë pozitive dhe ka numër më të madh të pikëve.

Kjo kompetencë, në periudhën e kaluar, nuk respektohej në mënyrë konsekuente, kështu që, nga Këshilli Gjyqësor, si ushtrues detyre në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, ishte përcaktuar gjyqtar nga Gjykata

48 Konkursi shpallet në "Gazetën Zyrtare të RM" dhe në më së paku dy gazeta ditore, nga të cilat njëra në gjuhë tjetër, të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve të RM dhe zgjat 15 ditë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të RM".

49 Neni 40 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM.

50 Neni 3 dhe neni 5 paragrafi 1 i ndryshimeve të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 197 nga data 29.12.2017

Supreme e RM, i cili gjatë punës së tij nuk tregoi rezultate dhe pas një kohe të shkurtër dha dorëheqje nga ai funksion.

Për zgjedhjen e kryetarit diskutohet dhe merret vendim në mbledhje në të cilën marrin pjesë më së paku dy të tretat e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor me të drejtë vote, ndërsa zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me kushte, procedurë dhe mënyrë ashtu siç bëhet zgjedhja e gjyqtarit në gjykatën përkatëse.

Gjatë zgjedhjes së gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës e cila ndodhet në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes lokale në të cilën 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, doemos duhet të respektohet përfaqësimi i drejtë dhe adekuat gjatë zgjedhjes, si dhe të diskutohet dhe të merret vendim në mbledhje në të cilën marrin pjesë më së paku dy e tretat e anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote. Si i zgjedhur konsiderohet kandidati i cili ka fituar dy të tretën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm të cilët u përkasin bashkësive të cilat nuk janë shumicë në RM.[51]

Në mbledhjen e mbajtur në nëntor për zgjedhjen e gjyqtarëve, për herë të parë u publikuan dy rank-lista edhe atë njëra mazhoritare dhe tjetra sipas parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, e përpiluar nga kandidatë të cilët u përkasin bashkësive etnike.

Pas rekomandimeve të dhëna në raportet e monitorimit, vihet re përpjekja e Këshillit Gjyqësor që të tregoj shkallë më të lartë të efektivitetit në punën e tij, me përpjekje për zbatimin e mundësive të dhëna ligjore gjatë përzgjedhjes së gjyqtarëve. Në këtë kontekst, vendimet për zgjedhje në vitin 2017 dallonin nga ato që janë miratuar në vitin 2016, meqë të njëjtat përmbajnë listë të plotë të kandidatëve të paraqitur, numrin e pikëve për punë, të dhëna biografike për të njëjtit, stazhin e përgjithshëm dhe rezultatet nga anketa anonime.

Megjithatë, nga analiza e vendimit për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të datës 23.11.2017, mund të konstatohet se nuk është e qartë se pse anëtarët e Këshillit Gjyqësor kanë votuar për kandidatët e zgjedhur kur sipas të dhënave në të dyja listat nuk kanë qenë më të mirët, as sipas numrit të pikëve për punë, e as sipas parametrave të tjerë, si për shembull, kohëzgjatja e stazhit.

Qëndrimi i këtillë i Këshillit Gjyqësor gjatë kryerjes së përzgjedhjes së gjyqtarëve shkaktoi revolt tek gjyqtarët, madje edhe kritika publike përmes mediave drejtuar Këshillit Gjyqësor.[53]

Në këtë periudhë, gjatë përzgjedhjes së kryetarëve të gjykatave, përveç kriterit numri më i lartë i pikëve, u mor parasysh edhe Programi i tyre i punës, si dhe përshtypjet nga intervistat e realizuara të kandidatëve, e që nuk ishte praktikë gjatë zbatimit të zgjedhjeve paraprake.

Me miratimin e Ligjit për ndryshime dhe plotësime të LKGJ është parashikuar e drejta e kandidatit i cili nuk është zgjedhur për gjyqtar ose kryetar të gjykatës të mund të paraqes ankesë deri te Gjykata Supreme e RM-së, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit, me çka është plotësuar zbrazëtira juridike e pamundësisë për paraqitjen e instrumentit të këtillë juridik (neni 3 paragrafi 3 dhe neni 5 paragrafi 3).

51 Neni 24 i Rregullores së punës së Këshillit Gjyqësor të RM.

Zbatimi i kritereve në procedurën e përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave

Kriteret, si element të rëndësishëm të procedurës për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarit, në përgjithësi janë përcaktuar në dispozitën e cila e rregullon zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë. Kështu, në nenin 41 paragrafin 2 të LKGJ, për gjyqtarë në gjykatë më të lartë, Këshilli do të zgjedh person i cili ka kualitete më të larta profesionale, i cili gëzon reputacion në kryerjen e funksionit të gjyqtarit, në bazë të kritereve si vijojnë:

1) njohuri profesionale dhe specializim në profesion dhe pjesëmarrje në trajnime të vazhdueshme;

2) raporti ndaj punës, me ç'rast merret parasysh respektimi i afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve porcesuale, respektimi i afateve ligjore për miratimin, publikimin dhe përpilimin i vendimeve, raporti midis numrit të vendimeve të konfirmuara, anuluara ose të modifikuara në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura, numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin orientues të lëndëve të cilat gjyqtari duhet t'i zgjidh në nivel mujor, të caktuar nga Këshilli;

3) aftësia për zgjidhjen e çështjeve juridike, me ç'rast merret parasysh shkalla e arritur e aspektit të drejtë dhe ligjor të vendimmarrjes dhe konstatimit gjyqësor, para së gjithash, në procedurat me mjete juridike;

4) ruajtja e reputacionit të gjyqtarit dhe gjykatës, me çka përcaktohet mënyra e zhvillimit të procedurës, komunikimi me palët dhe organet e tjera, ruajtja e pavarësisë, paanshmërisë, konfidencialitetit, rëndësisë dhe sjellja ndaj punës dhe jashtë saj;

5) aftësi për t'u shprehur gojarisht dhe me shkrim, e që pasqyrohet përmes vendimeve të përpiluara dhe veprimit gjyqësor profesional;

6) ndërmarrja e punës plotësuese gjatë kryerjes së funksionit të gjyqtarit me pjesëmarrje në zgjidhjen e lëndëve të prapambetura;

7) ndërmarrja e punës plotësuese gjatë kryerjes së funksionit të gjyqtarit përmes mentorimit, edukimit dhe ngjashëm;

8) raporti me bashkëpunëtorin dhe administratën gjyqësore; dhe

9) aftësia për kryerjen e detyrave me karakter udhëheqës.

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së gjyqtarëve sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor përbëhet nga:

- Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm dyvjeçar i punës së gjyqtarit;
- Rezultatet e përgjithshme të punës së gjyqtarit; dhe
- Kontributi i gjyqtarit në zhvillimin e sistemit juridik dhe mendimit profesional[52]

Këta parametra të procedurës për monitorim dhe vlerësim të punës së gjyqtarëve janë përfshirë me titullin "kriteret dhe procedura për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarit" e që krijon konfuzion në nocionin kritere, sepse korniza kohore e monitorimit, rezultatet e përgjithshme të punës dhe kontributi i gjyqtarit në zhvillimin e sistemit juridik janë parametra të cilët e përkufizojnë kornizën për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve, dhe jo kriteret për zgjedhjen e tyre në gjykatë më të lartë.

Notimi i punës së gjyqtarit mund të jetë i rregullt dhe i jashtëzakonshëm

NOTIMI I RREGULLT ËSHTË ai i cili bëhet një herë në dy vjet, përfundimisht me muajin mars të vitit rrjedhës;

NOTIMI I JASHTËZAKONSHËM është ai i cili bëhet sipas notimit të Këshillit gjatë zgjedhjes së gjyqtarit në gjykatë më të lartë ose gjatë ngritjes së procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit.

Si notimi i rregullt, ashtu edhe ai i jashtëzakonshëm, me kërkesë të gjyqtarit mund të përsëritet.

52 Neni 98, Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM.

Metodat e monitorimit dhe notimit

Notimi bëhet përmes kritereve **kuantitative** dhe **kualitative**, si dhe me **monitorim të drejtpërdrejtë** dhe **kritere plotësuese dhe raste të veçanta të notimit** në lidhje me kryerjen e funksionit të gjyqtarit.[53]

KRITERET KUANTITATIVE janë të dhënat dhe informacionet e pranuara përmes Sistemit informatikë automatik gjyqësor për administrimin e lëndëve, të ashtuquajtur (AKMIS) për numrin, llojin dhe lëndët e zgjidhura sa i përket numrit orientues të lëndëve që duhet t'i zgjidh gjyqtari gjatë një muaji.[54]

KRITERET KUALITATIVE kanë të bëjnë me raportin e gjyqtarit ndaj punës, siç janë:

1. respektimi i afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve procesuale;
2. respektimi i afateve ligjore për miratimin, publikimin dhe përpilimin e vendimeve;
3. raporti midis vendimeve të konfirmuara, anuluara dhe të modifikuara sa i përket numrit të përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura.

Ky kriter merret parasysh gjatë përllogaritjes së notës së punës së gjyqtarit, kundër vendimeve të të cilit janë deklaruar mjete juridike.[55]

Monitorimi i drejtpërdrejtë përfshin:

4. monitorim të vazhdueshëm të punës;
5. raportin e gjyqtarit ndaj lëndëve, palëve, gjyqtarëve, nëpunësve gjyqësorë;
6. udhëheqja e rregullt e dokumenteve/shkresave të cilat janë në punë tek gjyqtari, kualiteti i shprehjes gojore dhe me shkrim dhe respektimi i prioritetit gjatë zgjidhjes së lëndëve.

Kritere plotësuese

Ekzistojnë edhe kritere plotësuese kualitative, kur gjyqtari mund të fitoj maksimum 3 pikë edhe atë për publikimin e punimeve profesionale ose për materiale të përgatitura arsimore për nevojat e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Gjyqtari, do t'i fitoj këto pikë nëse shuma e pikëve, në bazë të kritereve kuantitative dhe kualitative, është më së paku 140 pikë.[56]

53 Neni 101, Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM
54 Neni 102, Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM
55 Neni 103, Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM.
56 Neni 112, Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM.

Raste të posaëme të notimit

Nëse puna e gjyqtari është e atillë që vendimet e tij nuk i nënshtrohen mbikëqyrjes së gjykatës më të lartë, përkatësisht kundër të njëjtëve janë deklaruar mjete juridike, kështu që për këtë shkak nuk mund të notohen sipas kritereve të kualitetit të vendimeve, atëherë puna e gjyqtarit do të notohet në bazë të monitorimit të vazhdueshëm të drejtpërdrejtë, mbi sjelljen e tij ndaj punës, respektimin e prioritetit në zgjidhjen e lëndëve me të cilat është i ngarkuar, në përputhje me raportin për punën e gjyqtarit, sjelljen ndaj palëve, gjyqtarëve dhe nëpunësve gjyqësorë, ndërkaq e gjithë kjo do të përcaktohet përmes parashtesave të parashtruara eventuale dhe përmes ankesave për punën e gjyqtarit, si dhe aktiviteteve të tjera (punë në këshillat gjyqësor, mentorim dhe ngjashëm).[57]

Prezantimi i këtillë i kritereve dhe pikëve çon deri në paqartësi dhe konfuzion në notimin e punës së gjyqtarëve, dhe në këtë mënyrë edhe deri në notën e fundit për avancimin e tyre. Gjatë monitorimit u konstatua pakënaqësi e caktuar, e shprehur nga ana gjyqtarëve, për shkak se konsiderojnë se bëhet notim joreal.

Për shkak të këtij konfuzioni, ndërthurja e kritereve vetvetiu dhe me parametrat e tjerë në përpunimin e veçantë të dispozitave të cilat e rregullojnë monitorimin e drejtpërdrejt, kriteret plotësuese dhe rastet e veçanta të notimit, ndarjen e kritereve e bën të paqartë dhe pamjaftueshëm të përshtatshme për zbatimin e procedurës për notimin e punës së gjyqtarëve. Prezantimi i pikëve nuk e nënkupton vlerësimin e plotë të punës së gjyqtarëve, përkatësisht nuk ekziston shprehje e vlerës në pikë në mënyrë që të përmbushet standardi – avancimi i sistemit të meritës ose merit-sistemi. Ky fakt, vetvetiu e vë në dukje nevojën për rregullimin ligjor më përkatës dhe më preciz të materies, për kriteret e nevojshëm dhe zbatimin e tyre në procedurën për notimin e punës së gjyqtarëve.

Nota e punës së gjyqtarit llogaritet përmes shumës së rezultateve të fituara nga kriteret kuantitativë dhe kualitativë (nuk përmenden fare elementët ose kriteret e tjerë nga neni 104, 112 dhe 114 të LKGJ) duke e marrë parasysh kohën efektive të punës. Gjyqtari mund të notohet me notë pozitive: kënaqshëm, mirë dhe shumë mirë ose me notë negative.

Mënyrën e llogaritjes së kohës efektive të punës e përcakton Këshilli, megjithatë, nga puna e deritanishme e Këshillit nuk është e qartë nëse e ka përmbushur këtë obligim dhe nëse dhe si, gjatë llogaritjes së notës është marrë parasysh fakti i kohës efektive të punës.

Edhe pse Këshilli Gjyqësor, edhe pas miratimit të vendimit për notim, përpilon aktvendim dhe të njëjtin ia dërgon gjyqtarit përmes kryetarit të gjykatës dhe deri te kryetari i gjykatës, megjithatë përmbajtja e të njëjtit është me karakter konfidencial, ndërsa kandidati i pakënaqur mund të kërkoj nga Këshilli të zbatohet notim i sërishëm.

Procesi i këtillë jotransparent për bazat e notimit të gjyqtarëve duhet të ndryshohet edhe atë jo vetëm për shkak të interesit të gjyqtarëve për notim të drejtë të punës dhe avancimit të tyre, por edhe për shkak të interesit publik të qytetarëve për sigurimin e profesionalizmit, pavarësisë dhe autonomisë së gjyqësorit në përgjithësi në RM.

Këshilli Gjyqësor bën notimin edhe të kryetarëve të gjykatave, edhe atë mbi dy baza:

1. nëse kryetari ka ndërmarr obligim për gjykimin e lëndëve, notimi bëhet sipas kritereve dhe procedurës për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarit dhe
2. monitorimi dhe notimi i punës së kryetarit të gjykatës si kryetar i gjykatës.

Nuk është e qartë se si do të notohet kryetari i cili ka marrë obligim për gjykimin e lëndëve sa i përket kriterit bazë – kuantitativ, i cili lidhet me llojin e lëndëve dhe numrin orientues të lëndëve, duke e marrë parasysh atë se i njëjti kryen edhe funksionin e kryetarit. Kryetari nuk mund ta realizoj normën orientuese dhe shtrohet pyetja që ky mosrealizim do të ndikoj në notën e tij.

57 Neni 114, Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM.

Bazë për llogaritjen e notës së punës të kryetarit të gjykatës, si kryetar i gjykatës është shuma e rezultateve të fituara nga kriteret e pranuara kuantitative dhe kualitative, si dhe nga rezultati i arritur në lidhje me organizimin e punës së gjykatës.

Kriteri kuantitativ paraqet përmbledhje të lëndëve të zgjidhura në gjykatë në lidhje me numrin orientues të lëndëve, i përpjesëtuar me numrin e seksioneve të gjykatës, me ç'rast merret parasysh përqindja e lëndëve të zgjidhura të vjetra të cilat kanë numër më të madh të pikëve.

Kriteri kualitativ për notimin e kryetarit të gjykatës paraqet përmbledhje të përqindjes së lëndëve të ndërprera të të gjithë gjyqtarëve në të gjitha seksionet.

Kriteret për organizimin e punës së gjykatës nga kryetari janë:

- puna e organizuar me efikasitet në lidhje me funksionimin e gjykatës;
- puna e gjykatës, informimi i publikut për punën e gjykatës;
- aplikimi i teknologjisë së informacionit; dhe
- puna financiare e gjykatës.

Ekzistojnë disa mospërputhje me Ligjin për gjykata në të cilin si kusht i veçantë për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë mund të zgjidhet personi **i cili në vitin e fundit nga ana e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë është notuar me notën më të lartë pozitive dhe në raport me personat e tjerë të paraqitur ka fituar numër më të madh të pikëve, konform ligjit.**

Nga ana tjetër, **neni 42 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor** parashikon se, megjithatë, për zgjedhjen e gjyqtarit, Këshilli Gjyqësor diskuton dhe vendos në mbledhje në të cilën marrin pjesë më së paku dy të tretat e anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote. Për gjyqtarë është zgjedhur kandidati i cili ka fituar dy të tretën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.[58] Kjo nënkupton se pavarësisht gjithë asaj që paraprakisht është theksuar, për gjyqtar, përkatësisht për kryetar zgjidhet ai person i cili do ta fitoj shumicën e nevojshme të votave nga anëtarët e KGJRM.

Duke filluar nga viti 2015 Këshilli Gjyqësor, duke iu referuar nenit 46 të Ligjit për gjykata, si dhe sigurimit të merit-sistemit, çdoherë e zgjidhte kandidatin e parë në listë i cili kishte numër më të madh të pikëve nga notimi i fundit. Kriteret e tjera, të parashikuara në nenin 41 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, nuk u përmendën, dhe as nuk u morën parasysh. Megjithatë, në zgjedhjet e muajit nëntor të vitit 2017, anëtarët e KGJRM; përveç pikëve nga notimi, i theksonin edhe kriteret e tjera të përcaktuara në nenin 41 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM.

Për shkak të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, e deri në zgjedhjet lokale (me përjashtime të caktuara për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave të cilët duhej doemos të zgjidhen) sipas rekomandimit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Këshilli Gjyqësor nuk e bënte zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave deri në nëntor të vitit 2017.

Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve për Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit në nëntor të vitit 2017, edhe pse ishte shpallur konkurs për 2 gjyqtarë në Gjykatën Supreme dhe 4 gjyqtarë në Gjykatën e Apelit, përkrah faktit se në konkurs u paraqitën 7 gjyqtarë për Gjykatën Supreme dhe më shumë se 50 për Gjykatën e Apelit Shkup, të cilët i përmbushnin kushtet konform ligjit, megjithatë, për Gjykatën Supreme u zgjodh vetëm një gjyqtar edhe atë nga lista e kandidatëve sipas parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, edhe pse kishte nevojë për dy gjyqtarë, ndërsa në Gjykatën e Apelit nga 4 gjyqtarët e nevojshëm u zgjodhën 3 gjyqtarë.

Transferimi dhe delegimi i gjyqtarëve

Gjyqtari e ushtron funksionin e gjyqtarit në gjykatën në të cilën është zgjedhur dhe kundër vullnetit të tij nuk mund të transferohet nga njëra gjykatë në gjykatën tjetër.

Me përjashtim, gjyqtari mund të transferohet në departament tjetër gjyqësor kundër vullnetit të tij me vendim të arsyetuar me shkrim të kryetarit të gjykatës, ndërsa sipas mendimit paraprakisht të siguruar nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë kur një gjë të këtillë e kërkon vëllimi dhe numri i rritur i lëndëve të cilat janë në punë në gjykatë, por më së gjati për një periudhë kohore prej një viti.[59]

58 Neni 42, Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM.
59 Neni 39, paragrafi 8, Ligji për gjykata.

Me **kalendarin vjetor të punës**, të cilin e përcakton kryetari i gjykatës, sipas mendimit paraprakisht të siguruar nga mbledhja e gjyqtarëve, përkatësisht nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, bëhet transferimi i gjyqtarëve, me ç'rast mbahet llogari për përcaktimin e gjyqtarit për specializimin në fushën penale, civile, ekonomike, administrative dhe në ndonjë fushë tjetër juridike.

Kjo dispozitë ligjore, mund të konstatohet se nuk ishte respektuar në mënyrë konsekuente, veçanërisht nga kryetarët e Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup dhe Gjykatës Supreme të RM gjatë vitit 2016, kur një numër i madh i gjyqtarëve u transferuan nga një departament në një departament tjetër jashtë kalendarit vjetor dhe pa pëlqimin e tyre, për çka kishte reagime të vrullshme jo vetëm nga gjyqtarët e pakënaqur por edhe nga kasta profesionale.

Kryetari i Këshillit Gjyqësor, në pres konferenca për media, sa i përket ritransferimit vlerësoi se kjo është punë e kryetarëve dhe se ata nuk mund dhe nuk kanë kompetencë të ndërhyjnë në punën e tyre.

Transferimi i përkohshëm është në kompetencë të Këshillit Gjyqësor të RM, i cili për vendimin e këtillë i njofton kryetarët si të gjykatës në të cilën është transferuar, ashtu edhe të gjykatës nga e cila transferohet gjyqtari.

Parashtrohet pyetja, a thua në këtë periudhë kohore, në lidhje me këtë çështje, Këshilli Gjyqësor e ka përmbushur funksionin e tij kryesor për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit, meqë transferimet e shpeshta janë element i cili mund të paraqes cenim të pavarësisë së gjyqtarëve.

Me përjashtim, gjyqtari i Gjykatës Themelore dhe i Gjykatës së Apelit mund të transferohet **përkohësisht të gjykoj** në gjykatë tjetër të nivelit të njëjtë ose në gjykatë më të ulët, ose nga një departament i specializuar në një departament tjetër, por më së gjati për një periudhë kohore prej një viti kur për shkak të pengesës dhe përjashtimit të gjyqtarit ose për shkak të rritjes së konsiderueshme të vëllimit të punës, azhurnitetit të reduktuar ose për shkak të kompleksitetit të lëndëve vihet në pikëpyetje puna rjedhëse e gjykatës.

Kundër vendimeve të Këshillit Gjyqësor për transferimin e përkohshëm, gjyqtari mund të paraqes kundërshtim në afat prej tri ditësh deri te Këshilli Gjyqësor.

Në rast të zgjidhjes së këtillë ligjore mund të konstatohet se Këshilli Gjyqësor në të vërtetë vendos në dy instanca, që mund t'i problematizoj standardet e vendimmarrjes nga ana e organit të pavarur dhe të mëvetësishëm.

Në periudhën e monitorimit Këshilli Gjyqësor, në disa raste, e vazhdoi transferimin e përkohshëm, i cili sipas ligjit është më së shumti deri në 1 vit. Si problem kryesor për vazhdimin e transferimit të përkohshëm është mungesa e gjyqtarëve në gjykata të caktuara.

Zgjedhja e gjyqtarëve - porotë

Zgjedhjen e gjyqtarëve-porotë e bën Këshilli Gjyqësor, me propozim të kryetarit të Gjykatës Themelore kompetente ose të Gjykatës kompetente të Apelit, me ç'rast, Këshilli Gjyqësor e realizon testin psikologjik dhe testin e integritetit, si për zgjedhjen e gjyqtarëve.

Këshilli Gjyqësor, gjatë periudhës kohore të monitorimit, në mënyrë efektive e ushtronte kompetencën e vet, sa i përket zgjedhjes së gjyqtarëve-porotë dhe disa herë konstatoi zgjedhjen dhe ndërprerjen e funksionit gjyqtar-porotë në disa gjykata të shtetit.

Megjithatë, problemi kryesor me të cilin ballafaqohet Këshilli Gjyqësor dhe gjyqësori në përgjithësi, është mungesa e gjyqtarëve-porotë, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të kandidatëve të cilët paraqiten në konkurse.

Për dukurinë e këtillë ka ndikim kompensimi i ulët prej 250 denarë për një ditë për kryerjen e punës gjyqtarë-porotë, si dhe kushti për posedimin e arsimit të lartë të kandidatit për gjyqtar-porotë, si dhe kufizimi i kufirit të moshës deri në 64 vjet.

Këshilli Gjyqësor, me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi, më shumë herë ka adresuar kërkesa me shkrim deri te Ministria e Drejtësisë për rritjen e shumës së kompensimit. Me shkresë iu drejtua edhe Ministrisë së Drejtësisë edhe Ministrisë së Financave me të cilën e theksoi kërkesën për takim, me qëllim të gjetjes së zgjidhjes për këtë problem.

Me amendimet e reja të Ligjit për Këshillin Gjyqësor parashikohet shfuqizimi i kushtit për posedimin e arsimit të lartë. Megjithatë, akoma nuk kemi informacione nga Ministria e Drejtësisë për ndryshimet e mundshme në lidhje me kompensimin monetar.

Shkarkimi i gjyqtarëve

Gjyqtari mund të shkarkohet nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit për shkak të:

- **shkeljes më të rëndë disiplinore, të përcaktuar me ligj, që e bën jo-dinjitoz për ushtrimin e funksionit;**
- **ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit me kushte të përcaktuara me ligj.**

Për shkelje të kryer më të rëndë disiplinore, kryetari i gjykatës e njofton Këshillin Gjyqësor, i cili pastaj vepron dhe merr vendim për shkarkim me dy të tretat e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Për ushtrimin joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit, sipas dispozitave ligjore, gjatë kohës së monitorimit procedura iniciohej me kërkesë të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, edhe më tutje vepron dhe merr vendim Këshilli Gjyqësor.

Pas ndryshimeve të Ligjit për Këshillin Gjyqësor procedura për përcaktimin e përgjegjësisë për gjyqtar ose për kryetar të gjykatës iniciohet sipas kërkesës së anëtarit të Këshillit Gjyqësor, të kryetarit të gjykatës, të kryetarit të gjykatës më të lartë ose në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme të RM-së.

Me ushtrimin joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit nënkuptohet profesionalizmi i pakënaqshëm ose i papërgjegjshëm i gjyqtarit, i cili ndikon mbi kualitetin dhe azhurnitetin e punës së tij.

Procedura para Këshillit Gjyqësor është urgjente dhe ka karakter konfidencial, dhe prandaj zhvillohet pa prezencën e publikut dhe duke e respektuar reputacionin dhe dinjitetin e gjyqtarit. Së këtejmi, mbahet llogari për mbrojtjen e të dhënave personale, konform akteve normative për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pas pranimit të kërkesës për përgjegjësinë e gjyqtarit, Këshilli, me short, e formon Komisionin për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose të kryetarit të gjykatës, të cilin e përbëjnë kryetari dhe dy anëtarë.

Kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor për shkarkimin e gjyqtarit nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, gjyqtari ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 8 ditësh pas pranimit të vendimit, deri te Gjykata Supreme e RM.

Në periudhën kohore të monitorimit, Këshilli Gjyqësor nuk ka publikuar vendim për shkarkimin e gjyqtarit.

Shkarkimi i kryetarëve të gjykatave

Kryetari i gjykatës mund të shkarkohet nga funksioni për shkak të:

- Keqpërdorimit të pozitës dhe tejkalimit të autorizimeve zyrtare;
- Përdorimit të paligjshëm dhe pa dedikim të mjeteve të gjykatës;
- Moskryerjes ose kryerjes jo në kohë të punëve të administratës gjyqësore;
- Ndikimit mbi pavarësinë e gjyqtarëve në lidhje me vendimmarrjen për lëndë të caktuara;
- Shkaktimit të çrregullimit më të rëndë të marrëdhënieve në gjykatë të cilat në masë të konsiderueshme ndikojnë mbi punën e gjykatës;
- Shkeljes së rregullave në lidhje me shpërndarjen e lëndëve;
- Mos-përmbushjes së Programit të punës;
- Nëse nga Këshilli Gjyqësor është notuar me notë negative;
- Nëse nuk e njofton Këshillin Gjyqësor për shkelje të kryer më të rëndë disiplinore nga ana e gjyqtarit.

Procedura e shkarkimit të kryetarit është identike me procedurën e shkarkimit të gjyqtarit.

Në periudhën kohore të monitorimit nuk ka shkarkim të kryetarit të gjykatës, edhe pse gjatë vitit 2016 kishte një numër të madh të indikacioneve dhe kallëzimeve të paraqitura nga gjyqtarë të Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup, të cilët shkaktuan çrregullime të rënda të marrëdhënieve në gjykatë, ndërsa të njëjtat në masë të konsiderueshme ndikuan mbi punën e tij.

Gjyqtari ose kryetari i gjykatës, kundër të cilit zhvillohet procedurë ka të drejtë për gjykim të ndershëm konform garancive të përcaktuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut.

Efektiviteti i Këshillit Gjyqësor në përmbushjen e funksionit të tij kryesor – sigurimi i pavarësisë së gjyqësorit

Në periudhën kohore të monitorimit u konstatuan dy lëshime thelbësore gjatë realizimit të funksionit kushtetues të Këshillit Gjyqësor. Së këtejmi, këto pikëpamje detyrimisht mbështeten edhe mbi të dhënat e raporteve relevante ndërkombëtare.

Lëshimet e Këshillit Gjyqësor në mënyrë efektive ta kontrolloj sistemin AKMIS, përkundrejt të gjitha kërkesave legjitime, paraqesin shkelje thelbësore të pozitës së tij kushtetuese dhe të kompetencave ligjore. Sigurimi i parimit të gjyqtarit të natyrshëm, përmes sistemit të shpërndarjes së rastësishme të lëndëve, është njëri nga kushtet themelore për një gjyqësor të autonom, të pavarur dhe të paanshëm, garantimi i të cilit është funksioni kryesor kushtetues i Këshillit Gjyqësor. Përveç kësaj, kontrolli i sistemit AKMIS si detyrë e rregullt, buron edhe nga dispozitat e nenit 128 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor sipas të cilit, notimi i kryetarëve të gjykatave bëhet edhe varësisht nga transparenca e punës së gjykatave me të cilat udhëheqin, si dhe nga **cenimi i rregullave për shpërndarjen e lëndëve**. Sipas kësaj, dëshmohet se Këshilli Gjyqësor në mënyrë sistematike e ka neglizhuar këtë obligim të tij gjatë notimit të punës së kryetarëve të gjykatave, me ç'rast në masë të konsiderueshme ka kontribuar për shfaqjen e pasojave kaq të rënda ndaj reputacionit dhe besimit në përgjithësi të gjyqësorit.

Me keqpërdorimin e sistemit AKMIS, të cilin Këshilli Gjyqësor me moskryerjen e detyrave të tij nuk ka arritur ta pengoj, vihet në pikëpyetje edhe kredibiliteti i vendimeve gjyqësore, kredibiliteti i notimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, si dhe të zgjedhjes së gjyqtarëve dhe kryetarëve bazuar mbi të dhënat jo-kredibile nga sistemi AKMIS.

Faktori i dytë i rëndësishëm për ushtrimin joefektiv thelbësor të funksioneve të Këshillit Gjyqësor është mosndërmarrja e veprimeve për shqyrtimin e dyshimeve për ndikime të palejueshme të pushtetit ekzekutiv mbi zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve, si dhe mbi vendimmarrjen e gjyqtarëve, veçanërisht e mbështetur me bisedat e përgjuara.

Këshilli për Përcaktimin e Fakteve

Këshilli për Përcaktimin e Fakteve u formua me qëllim që të sigurohet procedurë në dy shkallë gjatë procedurës disiplinore. Megjithatë, ligji u miratua me procedurë të shkurtuar dhe pa harmonizimin me Kushtetutën e RM, e që kontribuoi që të ketë reagime nga publiku ekspert, si dhe kritika nga Komisioni i Venecias.[60]

Këshilli i Fakteve nuk kishte ueb-faqe të vet meqë Këshilli Buxhetor Gjyqësor nuk realizoi prokurim përkatës për një gjë të këtillë. Këshilli i Fakteve, raportet për punën e tij i dërgonte përmes postës elektronike deri te mediat dhe deri te Instituti për të Drejtat e Njeriut.

Në dokumentet strategjike të Qeverisë u potencua suspendimi i këtij trupi.[61] **Këshilli për Përcaktimin e Fakteve pushoi së ekzistuari me miratimin e Ligjit për shfuqizimin e Ligjit për përcaktimin e fakteve në janar të vitit 2018.**

Në periudhën kohore të ekzistimit të tij, Këshilli për Përcaktimin e Fakteve punën e tij e ka kryer përmes mbajtjes së mbledhjeve më së paku një herë në javë.

Këshilli i Fakteve ka vepruar ndaj një numri të madh të parashtresave, madje edhe sipas zërit të dëgjuar, kryesisht në mbledhje të mbyllura, për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe integritetit të gjyqtarit.

Gjatë kohës së monitorimit, Këshilli i Fakteve ka pranuar një numër të madh të iniciativave, mesatarisht prej 14 deri në 53 në nivel mujor, ndërsa ka paraqitur **gjashtë kërkesa për përcaktimin e ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit. Në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor, brenda kësaj periudhe, janë publikuar gjithsej 3 vendime** prej të cilëve një kërkesë është hedhur poshtë si jo e plotë, një kërkesë si e palejueshme, ndërsa për të tjerat procedura nuk ka përfunduar.

60 Jurisprudenca dhe të drejtat themelore në Republikën e Maqedonisë, "Rrjeti 23", Komiteti i Helsinkit, viti 2015.

61 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Plani 3-6-9, në pjesën e reformave gjyqësore. I aksesshëm në: http://vlada.mk.

Analiza e pyetësorëve drejtuar publikut ekspert (avokatëve)

Instituti për të Drejtat e Njeriut, në shkurt të vitit 2018 dërgoi pyetësor deri te avokatët e RM[62] për punën e Këshillit Gjyqësor, me qëllim që të konstatoj ndryshim lidhur të mundshëm në lidhje me perceptimin e avokatëve për punën e Këshillit Gjyqësor, për dallim nga hulumtimi fillestar i zbatuar në tetor të vitit 2016.[63] Pyetësorët kësaj radhe, njëlloj iu dërguan 2000 avokatëve, ndërsa përgjigje pranuam nga 151 avokatë.

Përgjigjet e pranuara në këtë periudhë, në nivel të papërfillshëm, në drejtim pozitiv, dallojnë nga përgjigjet e pranuara në tetor të vitit 2016. Ajo që vërehet është numri i rritur mesatar i kërkesave të paraqitura për përjashtimin e gjyqtarit, si dhe numri i kërkesave të pranuara nga ana e kryetarëve të gjykatës. Njëherësh, për dallim nga analiza paraprake, kësaj here madje 25,7% e avokatëve janë përgjigjur se kanë paraqitur parashtresë deri te Këshilli për Përcaktimin e Fakteve kundër punës së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës.[64]

<u>Në pjesën në vijim të Analizës në mënyrë vizuale janë prezantuar përgjigjet e pranuara nga avokatët:</u>

1. A jeni të njoftuar me punën e Këshillit Gjyqësor të RM?



2. A konsideroni se Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është organ autonom dhe i pavarur?



3. A konsideroni se trupat e tjerë, institucionet dhe organet e respektojnë pavarësinë e Këshillit Gjyqësor të RM?



62 Pyetësori iu dërgua të gjithë avokatëve të cilët gjenden në listën e Dhomës së Avokatisë së RM dhe kanë posta aktive elektronike.

63 Analiza bazike e punës së Këshillit Gjyqësor të RM, Instituti për të Drejtat e Njeriut, f. 32. E aksesshme në: http://www.ihr.org.mk/uploads/publications_pdf/Analiza%20(MAK)%20web.pdf.

64 Në analizën paraprake në pyetjen: A kanë paraqitur parashtresë deri te Këshilli Gjyqësor ose deri te Këshilli për Përcaktimin e Fakteve, pasi e ka marrë këtë kompetencë, vetëm 3.60% janë përgjigjur se kanë paraqitur parashtresë.

4. Nëse jeni të njoftuar me punën KGJRM, a konsideroni se puna e KGJRM është transparente dhe e hapur??



5. Nëse përgjigjja është pohuese theksoni se si arrini t'i kuptoni më shpejtë informacionet e nevojshme për punën e KGJRM.



6. A keni paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit?



6.1. Nëse përgjigjja paraprake është pohuese, theksoni sa kërkesa keni paraqitur nga nëntori i vitit 2016 deri më tani (Ju ose pala juaj / nëse numri është më i madh theksojeni numrin e përafërt).

Përgjigjja e kësaj pyetje lëvizte nga 1 deri më 18.

6.2. Cilat janë shkaqet më të shpeshta për paraqitjen e kërkesës?

Shumica e përgjigjeve ishin, për shkak të: "njëanshmërisë, mosrespektimit të të drejtës materiale, njohjes me palën tjetër..." dhe ngjashëm.

6.3. Në këtë periudhë, sa nga kërkesat ju janë pranuar nga kryetari i gjykatës?

Përgjigja e kësaj pyetje lëvizte nga 1 deri në 10 kërkesa.

7. A keni paraqitur parashtresë kundër kryetarit të gjykatës ose gjyqtarit deri te Këshilli për Përcaktimin e Fakteve?



7.1. Nëse përgjigjja e pyetjes paraprake është pohuese, cili ka qenë epilogu?

Përgjigjja e kësaj pyetje lëvizte nga 1 deri në 5.

8. Sipas Jush, Këshilli Gjyqësor a e siguron dhe garanton autonominë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor?



9. Sipas Jush, zgjedhja e gjyqtarëve nga Këshilli Gjyqësor është:



Në pyetjen: "A e përdorini aplikacionin mobil "Këshilli Gjyqësor nën thjerrëz", i aksesshëm në Google play dhe Apple store?

93% janë përgjigjur se nuk e përdorin, ndërsa 7 % e përdorin.

Në pyetjen: "A konsideroni se aplikacioni i këtillë është i nevojshëm në mënyrë që të informoheni për punën e Këshillit Gjyqësor dhe a do ta aplikonit në të ardhmen?" :



Pyetësorë për publikun e gjerë

Pyetësorët për publikun e gjerë u publikuan në rrjetet sociale dhe përmes postës elektronike iu dërguan 500 personave. Në pyetjet e parashtruara pranuam përgjigje nga 189 qytetarë. Ideja ishte që përsëri të matet ndryshimi i mundshëm nga anketa e fundit për matjen e perceptimit të opinionit publik të realizuar në tetor të vitit 2016.[65]

Nga analiza e këtyre pyetësorëve mund të konstatojmë rritje të njohurive të qytetarëve me punën dhe me kompetencat e Këshillit Gjyqësor të RM. Madje 50 % janë njoftuar me punën dhe kompetencat e KGJRM, rreth 40% janë njoftuar pjesërisht, ndërsa vetëm 10% nuk janë njoftuar fare me punën dhe kompetencat e KGJRM.[66]

Të anketuarit, për punën e KGJRM, më së shpeshti informohen përmes mediave. Më pak se 8% informohen drejtpërsëdrejti nga faqja e internetit të KGJRM, 10% e ndjekin punën i tij përmes aplikacionit mobil "Këshilli Gjyqësor nën thjerrëz". Ndërkaq, më shumë se 10% nuk e ndjekin fare punën e KGJRM dhe nuk gjejnë shkak se pse do ta ndiqnin edhe në të ardhmen.

Përsëri, më shumë se gjysma e përgjigjeve janë se puna e Këshillit Gjyqësor nuk është fare transparente, gjysma tjetër konsideron se puna e KGJRM është pjesërisht transparente, ndërsa vetëm 2% konsiderojnë se puna e KGJRM është plotësisht transparente.

Vetëm 10% e të anketuarve ndonjëherë kanë paraqitur parashtresë kundër punës së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës.

65 Analiza bazike e punës së Këshillit Gjyqësor të RM, Instituti për të Drejtat e Njeriut, f. 39. E aksesshme në: http://www.ihr.org.mk/uploads/publications_pdf/Analiza%20(MAK)%20web.pdf.

66 Në tetor 2016 kësaj pyetje 33% e të anketuarve i janë përgjigjur se janë të njoftuar, 37% se pjesërisht janë të njoftuar dhe 30% se fare nuk janë të njoftuar me punën e Këshillit Gjyqësor të RM.

Vështrim i shkurtër i punës së këshillave gjyqësor në Republikën e Sllovenisë dhe Republikën e Kroacisë

Në tekstin në vijim është dhënë një pasqyrë e shkurtër e legjislacionit dhe punës së këshillave gjyqësorë në Kroaci dhe Sllloveni lidhur me kompetencat për zgjedhje dhe shkarkim të cilët çojnë në sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit, si dhe praktikat e transparencës që mund të shfrytëzohen si praktika të mira gjatë punës së Këshillit Gjyqësor të RM.

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Sllovenisë

Këshilli Gjyqësor i R. të Sllovenisë sipas ligjit është trup autonom dhe i pavarur, detyrë e të cilit është mbrojtja e pavarësisë dhe reputacionit të gjyqësorit dhe të siguroj kualitet në punën e gjykatave dhe gjyqtarëve. Çdoherë duhet të veproj në atë mënyrë që të mbrohet dhe fuqizohet besimi i publikut ndaj gjyqësorit, integritetit të gjyqësorit dhe pavarësisë së gjyqtarëve.[67]

Këshilli Gjyqësor i R. të Sllovenisë përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë. Kuvendi nacional zgjedh pesë anëtarë, me propozim të presidentit të Republikës, nga radhët e profesorëve universitarë të së drejtës, nga avokatët dhe juristët e tjerë, ndërsa gjyqtarët të cilët kanë funksion të përhershëm gjyqësor zgjedhin gjashtë anëtarë nga radhët e gjyqtarëve.

Funksioni i anëtarit të Këshillit Gjyqësor është funksion nderi dhe nuk është profesional, e që do të thotë se anëtarët vazhdojnë ta kryejnë funksionin, si për shembull, vazhdojnë të jenë gjyqtarë me gjysmë orari të punës. Të gjithë anëtarët kanë imunitet sa i përket mendimit të tyre në procesin e miratimit të vendimeve; Anëtarët zgjidhen me mandat prej gjashtë vjetësh (pa të drejtë rizgjedhjeje).

Kompetencat e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Sllovenisë-zgjedhja:

Zgjedhja e kandidatëve për gjyqtarë dhe propozimi deri te Kuvendi për zgjedhje (hyrja në gjyqësor); Emërimi i gjyqtarëve në funksionin e gjyqtarit; Emërimi dhe shkarkimi i kryetarëve dhe nënkryetarëve të gjykatave; Propozimi deri te Parlamenti për shkarkimin e gjyqtarit (largimi nga funksioni i gjyqtarit); Propozimi deri te Parlamenti për nominimin e gjyqtarit të Gjykatës Supreme; Avancimi i gjyqtarëve gjatë kohës së karrierës së gjyqtarit (përjashtime, nominime të Gjykatës Supreme); Vendimmarrja për papajtueshmërinë e funksionit gjyqësor; Vendimmarrja për referimin dhe transferimin e gjyqtarit: Miratimi i kritereve për zgjedhjen e kandidatëve; Miratimi i Kodeksit të etikës gjyqësore, me të cilin propozohen anëtarët e Komitetit për Etikë dhe Integritet; Dhënia e mendimit për organizimin e gjykatës, vendosje për numrin e vendeve të gjykatësve në gjykata; Dhënia e mendimit për paraburgimin e gjyqtarit dhe fillimin e procedurës penale kundër gjyqtarit.

Procedura në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Sllovenisë:

- Më së paku 8 anëtarë duhet të jenë të pranishëm në mbledhje në mënyrë që të miratohet vendim i plotfuqishëm;
- Votim i hapur i anëtarëve me shumicë votash;
- 2/3 e votave janë të nevojshme për miratimin e të gjitha vendimeve në lidhje me karrierën e gjyqtarit (zgjedhja, emërimi, nominimi, shkarkimi, përjashtimi) dhe miratimi i kritereve për zgjedhjen e kandidatëve për funksionin e gjyqtarit dhe kritereve për matjen e kualitetit të punës së gjyqtarëve;

67 Neni 2, Statusi i Këshillit Gjyqësor, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Sllovenisë (ZSSve).

Kontesti administrativ lejohet kundër të gjitha vendimeve të Këshillit Gjyqësor deri te Gjykata Supreme (dhoma prej pesë gjyqtarëve). Aktgjykimi duhet të miratohet në afat prej 30 ditësh dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i formës së prerë.

Kodeksi i etikës gjyqësore në Sllloveni

- Kodeksi i etikës gjyqësore miratohet nga Këshilli Gjyqësor;
- Gjyqtarët duhet ta respektojnë dhe ta ndjekin Kodeksin në shërbimin gjyqësor dhe jashtë gjykatës (në jetën private);
- Kodeksi është publikuar në ueb-faqen e Këshillit Gjyqësor dhe në ueb-faqen e gjykatave;
- Njëkohësisht, për zbatimin e Kodeksit ekziston edhe Komiteti për Etikë dhe Integritet:
- Përbëhet nga pesë (5) anëtarë të cilët janë vetëm gjyqtarë (një gjyqtarë është nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor);
- Anëtarët nominohen nga Këshilli Gjyqësor;
- Anëtarët kanë mandat prej 6 vjetësh, me mundësi për fitimin edhe të një mandati

Kompetencat e Komitetit për Etikë dhe Integritet

- Mendime për aktet (sjellja e gjyqtarit) të cilët paraqesin shkelje të Kodeksit;
- Rekomandime për respektimin e rregullave për etikën dhe integritetin e gjyqtarit lidhur me Kodeksin.
- Transparenca e punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Sllovenisë
- Votimi i hapur;
- Procesverbalet nga mbledhjet e Këshillit Gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet e gjyqtarëve, duhet të publikohen në ueb-faqen e Gjykatës Supreme;
- Të gjitha vendimet e Këshillit Gjyqësor në lidhje me karrierën e gjyqtarit (zgjedhja e kandidatëve, nominimi, promovimi ose përjashtimi) duhet të kenë shpjegime për motivet dhe duhet të publikohen në ueb-faqen e Këshillit Gjyqësor.

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kroacisë

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kroacisë është organ autonom dhe i pavarur i cili kujdeset për pavarësinë e gjyqësorit. Ai përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë, shtatë gjyqtarë, dy profesorë universitarë të drejtësisë dhe dy deputetë, prej të cilëve njëri nga opozita.

Anëtarët e Këshillit nga radhët e gjyqtarëve përzgjidhen nga të gjithë gjyqtarët e Republikës së Kroacisë, me votim të fshehtë, edhe atë dy gjyqtarë të gjykatave komunale, dy gjyqtarë nga gjykatat e qarkut, një gjyqtar nga gjykatat e specializuara (gjykata administrative, civile dhe gjykata tregtare), ndërsa dy gjyqtarë vinë nga Gjykata Supreme.

Anëtarët e Këshillit nga radhët e profesorëve universitarë të drejtësisë, me propozim të këshillave arsimorë, zgjidhen nga të gjithë profesorët e fakulteteve juridikë të Republikës së Kroacisë, ndërsa dy anëtarë të Këshillit emërohen nga Kuvendi i Kroacisë nga radhët e deputetëve prej të cilëve njëri është nga radhët e opozitës.

Këshillit Gjyqësor Shtetëror (KGJSH), në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, vendos për emërimin, avancimin, transferimin, shkarkimin dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, me përjashtim të kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kroacisë.

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kroacisë vlerësimin e gjyqtarit e kryen përmes pikave të përcaktuara kuantitative dhe kualitative.

Me kandidatët për gjyqtarë, Këshilli Gjyqësor Shtetëror zbaton intervistë të strukturuar me kohëzgjatje të përcaktuar, me ç'rast shqyrtohet dhe vlerësohet:

- aftësia për miratimin e vendimeve,
- ndjenja për drejtësi, kryerje e funksionit në mënyrë të drejtë dhe me përgjegjësi,
- motivimi për punë në gjyqësor,
- puna dhe aktivitetet e deriatëhershme të rëndësishme për kryerjen me sukses të funksionit.

Në intervistë, kandidati mund të fitojë më së shumit 20 pikë. Çdo anëtar i Këshillit, i cili ka marrë pjesë në zbatimin e intervistës, duhet ta notoj kandidatin në raport të posaçëm për suksesin. Numrin përfundimtar të pikëve e përcakton Këshilli përmes diskutimit, dhe nëse anëtarët nuk mund të merren vesh rreth numrit të pikëve, përcaktohet numri mesatar i pikëve. Vendimi i Këshillit Gjyqësor Shtetëror për zgjedhjen e gjyqtarëve duhet të bazohet mbi numrin e përgjithshëm të pikëve, ndërsa pastaj mbi shumën e pikëve të cilat e pasqyrojnë notën për kryerjen e funksionit të gjyqtarit dhe pikëve të fituara nga intervista.

Transparenca e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kroacisë

Rregullorja për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kroacisë përcakton transparencë në punë përmes njoftimeve të rregullta për mbledhjet, publikimit të vendimeve dhe njoftimeve për aktivitete të tjera të Këshillit. Mbledhjet e Këshillit për të cilat diskutohet dhe vendoset lidhur me çështje të përgjithshme janë transparente. Emërimi i gjyqtarëve dhe i kryetarëve të gjykatave është transparent, megjithatë, gjatë vendimmarrjes për shkarkim dhe procedura disiplinore, si dhe gjatë vendimmarrjes për dhënien e pëlqimit për inicimin e procedurës penale, që të miratohet ose të refuzohet privimi nga liria, janë përjashtuar nga publiku. Me kërkesë të gjyqtarit, kundër të cilit zhvillohet procedurë e këtillë, Këshilli mban diskutim publik.

Vendimet të cilat miratohen në mbledhje pa prezencën e publikut, janë çdoherë publike.

Këshilli, në ueb-faqen e tij, publikon informacione relevante për procedurat të cilat i zbaton, si dhe materialet relevante mbi bazë të të cilave është diskutuar dhe vendosur.[68]

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kroacisë, në ueb-faqen e tij, mundëson këshillim me publikun – "Savjetovanje s javnošću" në bazë të dispozitës së nenit 11, paragrafit 2 të Ligjit për qasje në informacione, me çka paralajmëron fillimin e konsultimeve me publikun e interesuar lidhur me miratimin e akteve nënligjore si: rregullore, rregullore për punë dhe ngjashëm.

68 Poslovnik državnog sudbenog vijeća Republike Hrvatske, I aksesshëm në: http://www.dsv.pravosudje.hr/index.php/dsv/media/files/poslovnik (15.1.2018)

Konkluzione	Rekomandime

3.1. Transparenca, llogaridhënia dhe efektiviteti, të cilët ishin objekt monitorimi të punës së Këshillit Gjyqësor të RM-së, nuk janë në nivelin e kënaqshëm edhe pse në periudhën e mëvonshme të monitorimit u vërejt një progres i caktuar në implementimin e këtyre standardeve.

3.2. Këshilli Gjyqësor, gjatë kryerjes së kompetencave të tij, mbante llogari për mundësimin e transparencës formale, megjithatë, mungon aspekti thelbësor i transparencës në mënyrë që publiku të mund t'i perceptoj bazat dhe shkaqet për vendimet që i miraton Këshilli.

R.2. Duhet të bëhet azhurnim më aktiv i ueb-faqes që të mundet në mënyrë të lehtë dhe efikase të sigurohen të dhëna relevante. Komunikimi me publikun, i cili mund të realizohet edhe përmes gazetarëve të jetë thelbësor, që publiku në mënyrë përkatëse të mund ta vlerësoj punën e Këshillit Gjyqësor.

3.3. Llogaridhënia e punës së Këshillit Gjyqësor, përmes raporteve vjetore të punës, nuk është e mjaftueshme me prezantimin e të dhënave statistikore dhe analitike, pa të dhëna plotësuese relevante për kryerjen e kompetencave. Shqyrtimi dhe miratimi i raporteve bëhet në mënyrë rreptësisht formale. Në praktikë nuk është vërejtur aktivitet i gjyqtarëve për raportet përkatës. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit nga Kuvendi i RM-së, në praktikën e deritanishme, nuk tregon diskutime esenciale dhe vlerësim përkatës të punës së Këshillit Gjyqësor.

R.3. Raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor nga aspekti përmbajtjesor duhet të jetë më cilësor, me qëllim që të mundësoj këqyrje gjithëpërfshirëse të gjendjeve të cilat e prezantojnë punën e tij. Nevojitet të sigurohet shqyrtimi dhe miratimi i Raportit edhe nga ana e gjykatave, veçanërisht nga Gjykata Supreme e RM. Të mundësohet zbatimi praktik i pasojave nga mosmiratimi i raporteve nga organet e lartpërmendura, të shoqëruara me argumentim të fuqishëm dhe të qartë për mosmiratimin.

3.4. Deri më tani, ligjvënësi nuk ka përcaktuar përgjegjësi për anëtarët e Këshillit Gjyqësor, dhe në këtë mënyrë nuk e ka përmbushur obligimin kushtetues të parashikuar në Amendamentin XXVIII të Kushtetutës së RM-së, i cili është miratuar në vitin 2005.

R.4. Ligjvënësi ta përmbush obligimin kushtetues, të përcaktohet me ligj përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, në atë mënyrë që do ta parashikoj bazën dhe procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së anëtarit të Këshillit.

3.5. Kriteret për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat më të larta janë të paqarta dhe lënë mundësi për notim joadekuat, e që e vë në pikëpyetje objektivitetin gjatë kryerjes së përzgjedhjes. Është vërejtur edhe transparencë e pamjaftueshme në aspekt të notimit të kandidatëve.

R.5. Për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat më të larta nevojitet të përcaktohen kritere të qarta dhe të sakta, të bazuara rreptësisht mbi merita. Për këtë shkak, është e nevojshme të rishikohet struktura e kritereve ekzistuese, monitorimi i drejtpërdrejtë, kriteret plotësuese dhe rastet e veçanta (nocione të përcaktuara me ligj), si dhe procedura për zbatimin e tyre në praktikë. Nevojitet që edhe notimi të jetë transparent.

3.6. Vërehet një qëndrim pasiv në punën e mbledhjeve, tek një pjesë e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor (në nivel të pamjaftueshëm e shfrytëzonin të drejtën e tyre për prononcim gjatë përzgjedhjes së gjyqtarëve, por edhe gjatë realizimit të kompetencave të tjera të Këshillit Gjyqësor).

R.6. Anëtarët e Këshillit Gjyqësor gjatë realizimit të kompetencave të tyre në mënyrë thelbësore t'i realizojnë obligimet e parashikuara me ndryshimet ligjore të muajit dhjetor të vitit 2017 edhe atë sidomos me prezantimin e qëndrimit të tij dhe mendimin e të gjithë anëtarëve në lidhje me zgjedhjen.

3.7. Moszgjidhja, pa arsyetim, e kryetarëve të gjykatave, të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkup dhe të Gjykatës Supreme të RM nga kandidatët e paraqitur në shpalljet publike, është pasqyrë e punës joefikase dhe joefektive e Këshillit Gjyqësor. Aq më shumë, meqë menjëherë më pas përsëri publikon shpallje për plotësimin e vendeve të njëjta.

R.7. Këshilli Gjyqësor në mënyrë efektive duhet t'i kryej kompetencat e tij, duke i shpenzuar mjetet publike të buxhetit në mënyrë efikase dhe transparente, me qëllim të sigurimit të efikasitetit dhe efektivitetit të gjyqësorit në përgjithësi.

3.8. Gjatë kryerjes së zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat themelore, Këshilli Gjyqësor de facto nuk e bëri përzgjedhjen, por gjyqtarët i emëroi nga rank-lista e kandidatëve të dërguar nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë (AGJPP), edhe pse përmes Këshillit Gjyqësor u realizua intervista dhe testimi për testin e integritetit dhe psikologjik. AGJPP, në kuadër të trajnimit fillestar, nuk ka mundësi t'i rankojë kandidatët sipas specializimit të tyre për ndonjë fushë të caktuar juridike, siç kërkohet në shpalljet e publikuara për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat themelore.

R.8. Pa hyrë në vlerësimin të cilin e zbaton Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, në kuadër të trajnimit fillestar, të mundësohet Këshilli Gjyqësor ta kryej kompetencën e tij – zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat themelore, në përputhje me parametrat e përcaktuar ligjor.

3.9. Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat më të larta, anëtarët e Këshillit Gjyqësor nuk votojnë për të gjithë kandidatët në listë, të cilët i përmbushin kushtet. Si i zgjedhur konsiderohet kandidati i parë nga rank-lista, i cili do ta fitojë shumicën e nevojshme për zgjedhje.

R.9. Votimi i këtillë duhet të pamundësohet, ndërkaq duhet të votohet për të gjithë kandidatët për gjyqtarë në gjykatat më të larta, në mënyrë që të mos krijohen dyshime gjatë zgjedhjes, ndërsa me qëllim të sigurimit dhe ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit.

3.10. Caktimin e kryetarit UD të Gjykatës Themelore Shkup 1 nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të RM-së, Këshilli Gjyqësor e bëri në kundërshtim me dispozitat ligjore (neni 89 të Ligjit për gjykata).

R.10. Veprimi i këtillë kundërligjor i Këshillit nuk e përforcon besimin ndaj gjyqësorit dhe gjithsesi nuk është në favor të sundimit të së drejtës dhe garantimit të autonomisë dhe pavarësisë së gjyqësorit, ndërsa praktika e këtillë duhet të ndërpritet.

3.11. Parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, gjatë zgjedhjes së fundit të gjyqtarëve u sigurua përmes publikimit të dy rank-listave, edhe atë njëra listë mazhoritare dhe lista tjetër me kandidatë nga bashkësitë etnike të cilat nuk janë shumicë në RM.

R.11. Publikimi i dy rank-listave të kandidatëve (njëra mazhoritare dhe lista tjetër me kandidatë nga bashkësitë etnike) e përmbush parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, me ç'rast nuk guxon të shpërfillet respektimi i të gjitha kritereve gjatë kryerjes së zgjedhjes së gjyqtarëve nga ato lista.

3.12. Vendimet për zgjedhjen e gjyqtarëve, të muajit nëntor të vitit 2017 përmbajnë listën e plotë të kandidatëve të paraqitur, me numrin e pikëve të notimit, me të dhënat biografike për kandidatët, stazhin e përgjithshëm dhe rezultatet e anketës anonime, por nuk mund të përcaktohet arsyeja se për çfarë shkaku, janë zgjedhur pikërisht ata kandidatë, kundrejt kandidatëve të pa zgjedhur të cilët gjenden më lartë në listë (sipas të dhënave të prezantuara kanë numër më të madh të pikëve apo numër identik të pikëve dhe kanë stazh më të madh dhe/ose përqindje më të madhe të besimit nga anketa anonime)..

R.12. Rekomandohet miratimi dhe publikimi i vendimit të qëndrueshëm objektiv dhe ligjor për zgjedhjen e gjyqtarëve, i cili do të përmbajë shkaqe të qarta për kandidatin e zgjedhur, kundrejt kandidatëve të tjerë nga lista. Shkaqet për justifikimin e vendimit janë të nevojshme për informimin e publikut dhe për realizimin efektiv të të drejtës për ankesë.

3.13. Këshilli Gjyqësor nuk reagoi në rastet e: (1) mosrespektimit të kompetencave ligjore nga kryetarët e gjykatave në lidhje me ritransferimin e gjyqtarëve nga një seksion në tjetrin jashtë kalendarit vjetor dhe pa pëlqimin e gjyqtarëve; (2) shpërndarjes së lëndëve përmes sistemit AKMIS; si dhe (3) bisedave të publikuara telefonike lidhur me pavarësinë e gjyqësorit.

R.13 Për mos-reagimin e këtillë nga Këshilli Gjyqësor nevojitet të përcaktohet përgjegjësi përkatëse.

3.14. Mënyra ekzistuese elektronike e nënshtrimit në provimin e jurisprudencës, që është kusht themelor për zgjedhje, nuk siguron njohuri të mjaftueshme nga fusha juridike për kryerjen e funksionit të gjyqtarit.

R.14. Nevojitet të bëhen ndryshime në programin e provimit të jurisprudencës dhe në mënyrën e nënshtrimit të provimit.

3.15. Gjatë zgjedhjes së kryetarëve të gjykatave, në nëntor të vitit 2017, për herë të parë, përveç kriterit numri më i lartë i pikëve, u notua edhe Programi i paraqitur për punë dhe kualiteti i kandidatit nga intervista e realizuar, e që vlerësohet si qasje pozitive.

3.16. Këshilli Gjyqësor manifestoi interesim më të madh për tejkalimin e problemit me mungesën e gjyqtarëve-porotë dhe për kompensimin e ulët për kryerjen e punës gjyqtar-porotë, e që vlerësohet si qasje pozitive.

Kjo analizë është rezultat i: a) monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor, b) debateve të organizuara publike me publikun specialist dhe ekspert në të cilat u theksua se Këshillin Gjyqësor nuk e perceptojnë si garant të mjaftueshëm të autonomisë dhe pavarësisë së gjyqësorit dhe punës së tyre profesionale, c) diskutimeve me gazetarët si gardianë të interesit publik të cilët manifestuan transparencë të pamjaftueshme ndaj Këshillit Gjyqësor, ç) anketave të realizuara lidhur me këndvështrimin e perceptimit të publikut profesionist dhe të përgjithshëm, ç) por edhe të aktiviteteve të tjera të projektit të cilat janë rezultat i punës shumëvjeçare të Institutit për të Drejtat e Njeriut në këtë fushë, nga të cilat rezulton nevoja për deprofesionalizimin e punës së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor. Komunikimi me publikun të jetë thelbësor, në mënyrë që publiku të mund ta vlerësojë në mënyrë adekuate punën e Këshillit Gjyqësor, si dhe të përmbushet interesi publik. Për shkak të realizimit thelbësor të transparencës, e cila është më se e dukshme se mungon, nevojitet angazhim më i madh i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe shërbimit profesional si dhe nevojitet të krijohen mundësi për aftësime profesionale në këtë drejtim.

Me zbatimin e këtyre aktiviteteve janë siguruar të dhëna të mjaftueshme relevante për punën e Këshillit Gjyqësor dhe për vlerësimin e punës së tij, megjithatë, duke i pasur parasysh ndryshimet e caktuara ligjore, si dhe duke iu referuar ndryshimeve të paralajmëruara thelbësore ligjore, që do të pasojnë së shpejti, nevojitet monitorim plotësues mbi zbatimin praktik të këtyre dispozitave.